



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES SË JASHTËZAKONSHME TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS
SË KOSOVËS, E MBAJTUR MË 14 DHE 30 TETOR 2024**

**SA VANREDNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 14. I 30. OKTOBRA 2024. GODINE**

**TETOR - OKTOBAR
2024**

Rendi i ditës

1. Debat parlamentar për mungesën e ushqimit në Ushtrinë e Republikës së Kosovës.

Dnevni red

1. Parlamentarna rasprava o nedostatku hrane u Vojsci Republike Kosovo.

Mbledhjen e drejtoi nënkryetari i Kuvendit, z. Enver Hoxhaj.

KRYESUESI: Të nderuar deputetë,

Të nderuara zonja dhe zotërinj, më lejoni që t'i hap punimet e seancës së jashtëzakonshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës me kërkesën e 43 deputetëve të Kuvendit.

Të nderuar deputetë,

Në bazë të nenit 69, paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe neni 68, paragrafi 3 të Rregullores së Kuvendit, 43 deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës kanë kërkuar seancë të jashtëzakonshme për të debatuar në lidhje me mungesën e ushqimit në Ushtrinë e Republikës së Kosovës, si dhe kanë propozuar rezolutë për miratim.

1. Debat parlamentar për mungesën e ushqimit në Ushtrinë e Republikës së Kosovës

Ftoj deputetin Bekë Berisha, nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, që në emër të deputetëve nënshkrues ta paraqesë çështjen për të cilën është kërkuar kjo seancë e jashtëzakonshme.

BEKË BERISHA: Faleminderit, kryesues!

Është hera e parë që në këtë Kuvend duhet trajtuar një temë pa dëshirën time, besa edhe pa dëshirën e asnjërit prej neve këtu.

Të dashur qytetarë dhe ushtarë të ushtrisë së Kosovës, të FSK-së, sot jemi këtu për të diskutuar një çështje tejet të rëndësishme për sigurinë e Kosovës dhe për funksionalitetin e Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Ushtria jonë është krenaria e vendit tonë dhe është simbol i shpresës për një të ardhme të sigurt dhe të qëndrueshme, secili ushtar që shërben ka vendosur t'i shërbejë vendit deri në vetëfljirim. Nuk janë aty as për privilegje, por as për kushte. Aty janë djemtë e vajzat më të mirë të kombit tonë. Megjithatë, duhet të pranojmë se situata aktuale është tepër shqetësuese. Trajtimi i ushtarëve tonë me neglizhencë është një shkelje e rëndë e përgjegjësisë së udhëheqjes së kësaj qeverie. Kriza e furnizimit me produkte esenciale për FSK-në është një sinjal alarmant që kërkon zgjedhje të menjëhershme. Të mos harrojmë ne jemi në një kohë të rrezikshme për sigurinë në rajon dhe është thelbësore që sektori i sigurisë të trajtohet me prioritet dhe me dinjitet. Gatishmëria e FSK-së për të kontribuar në paqe dhe siguri kërkon mbështetje të plotë nga të gjitha institucionet e Kosovës.

Pyetja që ne si deputetë duhet të shtrojmë sot është si mund të jemi të sigurt nga kjo mazhorancë që do të avancojë planin 10-vjeçar të transformimit të FSK-së në përputhje me standardet e NATO-s nëse nuk arrin të menaxhojë as furnizimin me ushqim për ushtarët tanë. Prandaj, sot kërkojmë një përgjigje të qartë nga qeveria, sot kërkojmë zgjedhje të menjëhershme dhe urgjente. Ushtarët nuk duhet të jenë të shqetësuar se a kanë ushqim gjatë ditës dhe se me çfarë kualiteti u servohen shujtat. Ata duhet të jenë të preokupuar vetëm me pjesën e detyrave që i

kanë, një ushtar nuk duhet të ketë shqetësim ushqimin, uniformën, mungesën e veshmbathjeve. Nëse ju e quani veten qeveri, këto gjëra nuk lejohet të ndodhin, besa nuk kanë ndodhur në asnjë qeveri më herët. Duhet me ngulm t'i përmbushni obligimet që ju i keni dhënë dhe jo të propagandoni ashtu qysh veç ju dini.

Po jua përsëris, nuk ka lojë me ushtri. Mbajeni detyrën, plotësojani kushtet, përndryshe shteti dështon edhe ju në krye me të. Qytetarët e Kosovës po e sjellin vëmendjen e juve sot, jemi duke folur për institucionin më hierarkik, aty ku hierarkia është ligj, aty ku jepet urdhri, aty ku kryhet puna edhe detyra. Paramendojeni, në këtë institucion ku ishte dashur disiplina të jetë më e madhja, vjen puna që kjo qeveri ta lërë ushtrinë pa bukë dhe na bënë horë. Këtë tender, këta tenderë, këta të ushqimit, këtu ishte fitimi i madh. Nëse tenderi është 10 euro, me 3 euro po kryheshin obligimet, të tjerat shkojnë nëpër xhepa të njerëzve që unë i di. Unë sot e kam një kallaballëk dokumentesh, informacione, plot aty. Edhe i di të gjitha, ashtu qysh i dimë plot ne, mirëpo që 4 vjet mandat, duke dashur ta ruajmë ushtrinë, plot gjëra që i kemi ditur, nuk i kemi folur, i kemi mbrojtur, e dinë këta që janë në qeveri.

Ka shumë evidenca, ka materiale, por tash shtrohet pyetja: Nëse ka mbërritur Mihajli të hyjë në Ministri të Mbrojtjes, çka nuk di komshia, të gjitha i di! Ne mund t'ia mbajmë fshehtë këtu njëritjetrit, e ajo të gjitha i ka kallëzuar, se qëllimi i saj është për t'i ditur tjetër kush këto gjëra. Për krejt këtë neglizhencë, për ta kthyer dinjitetin, sot ishte dashur të zgjidhet problemi dhe të japë dorëheqje ministri, zëvendësministri, sekretari i zgjedhur jashtëligjshëm, për këta deputetë që janë klub aty, që i organizojnë këto sene, këta nuk e dinë qysh është puna. Sot më ka pyetur një televizion pse nuk janë mazhoranca këtu, unë gabimisht ju thashë “nuk kanë fytyrë”. Po këtyre për fytyrë s'ua ndien hiç.

Sa i përket konferencës për shtyp që po më çojnë selame, ne këtu se qysh duhet ruajtur ushtrinë, ushtrinë duhet ruajtur ju, nuk duhet vjedhur. Ashtu ruhet ushtria, ne qëllimin e kemi veç t'ua ngremë dinjitetin atyre djemve e vajzave më të mira të Kosovës, ashtu qysh duhet. Faleminderit shumë do të përfshihemi në debat prapë dhe ju falënderoj shumë për nënshkrimet dhe për gatishmërinë për të debatuar për këtë temë.

Faleminderit!

KRYESUESI: Tash, fjalën ia kaloj Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, ftoj deputetin Hisen Berisha që në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së të marrë fjalën.

HISEN BERISHA: I nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë të opozitës të pranishëm,

Dua të vë në pah se kështu kanë munguar çdo herë deputetët e pushtetit, kur duhet të përballen në debate, ku flitet me gjuhën e nevojave të popullit, kur duhet të përballen me premtimet e papërmbajtura dhe kauzat e rrejtshme me të cilat kanë ardhur në pushtet.

Kjo është fjala që kurrë s'do të dëshiroja ta mbaj, jo vetëm për shkak të kodit ushtarak që më kufizon, por asnjëherë nuk do të dëshiroja të flas rreth ushtrisë, për probleme logjistike, për një ushtri ku të rinjtë nuk konkurrojnë për t'u bërë pjesë e krenarisë që të japë uniforma, arma dhe detyra e ushtarakut, e më keq për një ushtri nga e cila ikin ushtarët, nënoficerët dhe oficerët për shkak të kushteve të shërbimit jodinjitoze, për paga, çizme e uniforma, e për mungesën e ushqimit. Kjo është vetëm njëra anë e pasojave të keqmenaxhimit të ushtrisë sonë.

Por, e vërteta është se asnjë ushtar s'e ka lënë uniformën për shkak të ushqimit apo bashkimeve familjare e tjera trillime që janë munduar të mbrohen nëpër media e para nesh, por janë një mori shkaqesh demotivuese të tjera, siç janë: pagat dhe kushtet e shërbimit jodinjitoze, manipulimet me gradime jomeritore, trajnimet jashtë vendit me manipulime, puna jashtë orarit, mungesa e transportit vajtje-ardhje, duke i lënë në pozitë tejet degraduese ushtarët, e të tjera.

Më duhet të parafrazoj veten, në gjykimin e kësaj qeverie dhe politikave të saj. Mbetem pranë qëndrimit se kjo qeveri ka agjendë për zhbërjen e shtetit të Kosovës, duke e stërkequr procesin politik dhe funksionalitetin institucional të saj, deri te segmenti i fundit në mozaikun e shtetbërjes që janë Forcat e Armatosura të Kosovës. Deri më sot kanë arritur të falimentojnë shtetin në aspektin zhvillimor, ekonomik, social, infrastrukturor, politik, tani edhe në aspektin e sigurisë, duke cenuar institucionet kyçe të sigurisë dhe mbrojtjes, siç janë policia, që ditë më parë i detyruan të protestojnë para qeverisë për kushtet e shërbimit dhe ushtria në formim e sipër, përmes keqmenaxhimit të vazhdueshëm.

Hapi i parë i shkatërrimit ishte projekti për “shërbimin e detyrueshëm” ushtarak, si mekanizëm që deshën ta minojnë Projektin e ushtrisë profesioniste. Albin Kurti, për efekte elektorale, premtoi shërbimin e detyrueshëm ushtarak në Kosovë. Por, ai nuk arriti të krijojë kapacitete që të sigurojë bukën për ushtrinë që kemi krijuar për 25 vjet, e ky është mashtrimi i madh i Albin Kurtit. Pasi kjo tendencë dështoi, sepse aty kujdestaron prania ushtarake ndërkombëtare, me theks aleati kryesor, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, atëherë e ndryshuan idenë, duke u munduar ta shtyjnë një projekt me rrënjë nga e kaluara social-komuniste. Së fundmi, nga raporti final i Rishikimit Strategjik të Sektorit të Sigurisë, ku janë analizuar kapacitetet ekzistuese dhe ato që duhen krijuar sipas skenarëve nga të gjitha institucionet e vendit, dikasteret dhe agjencitë, përfshirë edhe edukimin e qytetarëve në fushën e Mbrojtjes, po e promovojnë një koncept të Mbrojtjes Gjithëpërfshirëse.

Nisur nga fakti se Plani Gjithëpërfshirës i Tranzicionit mbështet mjaftueshëm krijimin e Forcave të Armatosura të Kosovës, e tëra kjo bëhet vetëm për të përmbushur ambicien e tyre deficitare në shtetbërje, për t'i dhënë autorësi partiake edhe këtij projekti, siç kanë bërë me tërë infrastrukturën ligjore. Pas dështimit për minimin e projektit për ushtrinë profesioniste, shfrytëzuan një mundësi që patën në dorë, emërimin e personelit kyç në pozitë kyçe. Çfarë janë pozitë kyçe? Pozitat dhe personeli kyç e garantojnë implementimin e projektit të Forcave të Armatosura. Ky personel kur

është joadekuat dhe joprofesional, atëherë shumë lehtë bie në shërbim të së keqes, thoshte profesor Bardhyl Çaushti dhe u vu në shërbim të politikës dhe na ka sjellë në situatën që ushtria të rrezikojë dështimin në procesin e tranzicionit për shkaqe jo vetëm logjistike.

Komandanti i forcës paralajmëroi suspendimin e të gjitha aktiviteteve ushtarake në forcë, diçka që duhet shqyrtuar në hierarkinë subordinuese deri te Komandanti Suprem, i cili, fatkeqësisht, heshtimisht është pjesë e këtij komploti kundër Forcës.

Çështja e ushqimit për ushtarët e FSK-së është një sinjal i qartë i problemeve të menaxhimit dhe mungesës së përgatitjes afatgjatë. Tanimë e kanë kuptuar se ashtu siç nuk ishte i aplikueshëm koncepti i shërbimit të detyrueshëm ushtarak, edhe ideja për ngritjen e kapaciteteve të vetëqëndrueshme për ushqim në Forcë është një ide që do e komprometojë Forcën.

Komandanti i Forcës ka paralajmëruar, përveç mungesës së ushqimeve, edhe rrezikut të helmimeve, edhe ndërprerjen e aktiviteteve të planifikuara ushtarake të Forcës, nëse nuk merren masa urgjente për situatën. Këto probleme, të cilat janë përkeqësuar nga mospërdorimi dhe mosprocedimi me kohë për furnizim me ushqime në Forcë, si dhe dështimi i improvizimeve, po rrezikojnë jo vetëm shëndetin e ushtarëve, por edhe operacionalitetin e Forcës. Me këmbëngulje po konsistohet në idenë e vetë qëndrueshmërisë, saqë është shpallur konkurs për 105 kuzhinierë e staf, për t'i aktivizuar kuzhinat ushtarake në çdo repart e me siguri duhen edhe ushtarë që të hiqen nga përgatitja si "ushtar profesionistë" dhe të bëhen kamerierë ushtarakë. Pastaj duhet njësi e veçantë për furnizim me asortimente ushqimore, pastaj pajisje për konservimin dhe ruajtjen e tyre dhe po t'i vihet lapsi kësaj, kostoja do e rëndojë qëndrueshmërinë financiare të Forcës dhe prapë s' do ketë sukses.

Është e papranueshme që një institucion kyç për sigurinë kombëtare të përballet me një menaxhim të tillë të dobët, sidomos kur këto çështje janë procedura të njohura prej kohësh. Po t'i referohemi dokumentit publik të operatorëve ekonomikë që kanë aplikuar në tenderin për furnizim me ushqime në Forcë, konkurruesi i dytë në bazë të dokumentit që kam siguruar vetë, sipas çmimit, bazuar në "raportin e vlerësimit", i ka plotësuar të gjitha kriteret teknike dhe profesionale, dhe është cilësuar si i "i përgjegjshëm" dhe në bazë të referencave të ofruara, ka eksperiencë në furnizime të ngjashme edhe me KFOR-in që nga paslufta. Do të thotë, se ministria ka mundur të bëjë zgjidhje më të shpejtë sipas Ligjit të prokurimit, ta negociojë kontratën me operatorin e dytë me radhë, pasi që fituesi është tërhequr, jo vetëm pse kishte ofruar çmime abnormalisht të ulëta, 7 euro ta mbajë një ushtar në ditë, por, edhe sepse i është dashur kohë për ngritjen e kapaciteteve teknike për furnizim me ushqime të Forcës. Arsyet pse i është dhënë, duhet t'i japin ata që e kanë përzgjedhur.

Prandaj, kjo situatë duhet parë në dy prizma, të dashjes dhe qëllimit, si elemente të inkriminueshme. Për faktin se dihen procedurat e tenderimit për ushqim dhe çdo segment tjetër

logjistik që mban operacionalitetin e Forcave, atëherë kjo çfarë po ndodh me Forcën ka vetëm një emër: sabotim i qëllimshëm i një institucioni kyç për sigurinë dhe stabilitetin e vendit. Lufta politike, propaganda që kanë bërë vazhdimisht ka qenë e fokusuar në degradimin e vlerave shtetërore, mohimin e çdo arritje, deri edhe e simboleve shtetërore dhe vetë shtetit duke e trajtuar si projekt të përkohshëm. Kjo kulturë përçarëse e denigruese që kanë instaluar, u shpërfaq edhe kur protestuan arsimtarët, edhe kur protestoi policia, edhe tani kur komandanti shfaqti publikisht shqetësimin për situatën me ushqimin në Forcë dhe masat që do ndërmerren, në adresë të Ministrisë së Mbrojtjes.

Në asnjë rrethanë nuk do të kisha pasur kurajë morale të them fjalët me të cilat u shërbyen ushtarët tuaj të Facebook-ut, kundër Komandantit të Forcës. Si konsekuencë e kësaj kulture të urrejtjes që keni instaluar, e pamë të njëjtin reagim edhe kur u përmyt Skenderaj nga uji, deri te lutja që të mbyten të gjithë. Dhe kush? Drenica dhe Prekazi i familjes Jashari, që sakrifikoi 56 anëtarë të familjes, që ju ta fyeri dhe ta lëndoni sot. Mediat që po ju shërbejnë si mjet propagande dhe përçarjeje të qytetarëve, po e çojnë situatën deri në atë shkallë sa të mobilizohen njerëzit të prekur në sedër, për të ndëshkuar ata që lëndojnë vlerat e luftës dhe ushtrinë e Kosovës. Kjo do të thotë shtyrje qytetarëve drejt një përplasje civile. Edhe më tragjik është fakti se për katër vjet rresht e keni terrorizuar popullin, duke thënë se Serbia do të na sulmojë. Atëherë, sa dhe çfarë keni investuar në ngritjen e kapaciteteve për mbrojtje? I keni detyruar të largohen nga Forca edhe ushtarë, të cilët për shërbimin në Forcë janë betuar mbi gjakun e prindërve dëshmorë. Agron Hasanaj, djali i vetëm i babait dëshmor Shefqet Hasanaj, po ashtu djali i vetëm vëlla i nëntë motrave është detyruar ta lëshojë Forcën mu për shkak kushteve të shërbimit jodinjitoz.

Kjo është Forca dhe investimi që ju keni bërë? Këto janë veprimet e kësaj qeverie, që për gati gjashtë vjet ka punuar për të dobësuar shtetin dhe institucionet e tij kryesore, përfshirë edhe Forcën. Po jua them me keqardhje të madhe, keni tradhtuar interesat kombëtare të vendit. Është koha që të veprojmë, që ta ndalim këtë sabotim të qartë dhe të ruajmë integritetin e Ushtrisë sonë dhe të institucioneve tona të sigurisë dhe shtetit.

Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Tash e ftoj Anton Qunin në emër të Lidhjes Demokratike të Kosovës.

ANTON QUNI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Të nderuara media,

Qytetarë,

Sot në emër të Lidhjes Demokratike të Kosovës, qëndroj këtu për të ngritur një shqetësim thelbësor që prek jo vetëm sigurinë kombëtare të vendit tonë, por edhe shëndetin dhe mirëqenien e ushtarakëve tanë, njerëzve të cilët japin më shumë se gjithçka për vendin.

Është detyrë parësore e Ministrisë së Mbrojtjes të sigurojë mirëqenien e ushtarëve dhe të tregojë kujdesin dhe përkushtimin më të lartë për të siguruar kushtet e përshtatshme për operimin dhe mbarëvajtjen e të gjitha proceseve teknike, operacionale, logjistike, pajisjeve dhe ushqimit për ushtarët tanë. Në këtë kuptim dua të përmend që është thelbësore që Ministria e Mbrojtjes të sigurojë që proceset e prokurimit për Forcën e Sigurisë së Kosovës të jenë në përputhje me parimet dhe standardet më të larta të transparencës, konkurrencës së drejtë dhe standardet e NATO-s.

Pra, nga përvojat e vendeve anëtare të NATO-s, ku Kosova aspiro anëtarësimin, është absolutisht e papranueshme që një procedurë kaq e rëndësishme, si ajo për ushqimin e ushtrisë tonë, të shpërfaqë shkeljet elementare, ku procedurat e tilla fillimisht klasifikohen si sekrete, e më pastaj si procedurë ekstreme emergjente në kundërshtim të plotë me legjislacionin dhe praktikatat e mira të ministrive të mbrojtjes të shteteve demokratike.

Ligji i prokurimit publik në Kosovë përcakton qartë se prokurimet e klasifikuara lejohen vetëm në rastet e jashtëzakonshme, ku kërkohet siguri kombëtare, neni 3, ose në rastet e emergjencave ekstreme, neni 35. Në rrethanat ekzistuese ushqimi nuk përbën asnjë nga këto raste dhe mund të planifikohet në mënyrë efektive. Ndërkaq, përjashtimi i vetëm duhet të jetë në rastet kur FSK-ja angazhohet në misione ndërkombëtare, ku furnizimi me ushqime të freskëta mund të jetë i pamundur, ku eventualisht sipas vlerësimeve mund të aplikohen procedura të tilla.

Ministria e Mbrojtjes nuk ka arritur të planifikojë përfundimin e kontratës së furnizimit me ushqim në mënyrë të duhur dhe me kontraktorin e mëparshëm kishte lidhur një kontratë të ngjashme urgjente mbi tri herë për periudha deri në gjashtë muaj, me një vlerë mbi 7 milionë euro, duke u bazuar në procedurat e shpallura ekstreme emergjente. Por, Kosova nuk ka shpallur gjendje emergjente kombëtare. Ushqimi nuk është një emergjencë e papritur, është diçka që mund të planifikohet me kalendar dhe me transparencë.

Përtej kësaj, sot edhe pas një viti e gjysmë Ministria e Mbrojtjes përsëri pa një planifikim adekuat dhe pa ndjekur procedurat adekuate sipas parimeve të transparencës dhe konkurrencës së lirë kishte vendosur të aplikojë një procedurë të ngjashme ekstreme emergjente, duke anashkaluar në tërësi planifikimin adekuat sipas konkurrencës së hapur dhe të drejtë për të angazhuar një kontraktor tjetër që quhet “Hajdini”, që në rrethana të pasqaruara për publikun kontrata ka mbetur peng nga një zyrë në tjetër të ministrisë.

E ndërkohë që qarkullojnë gjithfarë spekulimesh për aranzhimet e çakorduara të momentit me mensat e studentëve apo qendrave korrektuese, duke krijuar paqartësi dhe pasiguri për të reflektuar negativisht mbi kredibilitetin e institucionit më të besueshëm në Kosovë. Legjislacioni për sektorin e mbrojtjes e bën përgjegjës Qeverinë për sigurimin e mirëqenies së ushtarëve tanë. Mirëpo, pyetja që duhet të bëjmë sot është: a po e bën kjo Qeveri me të vërtetë këtë detyrë jetike? Përse po dëgjojmë ende raportime për mungesë të standardeve në ushqim dhe për tenderimet e dyshimta për furnizimin me ushqim.

A po përdorin kompanitë e specializuara me përvojë ndërkombëtare dhe të licencuara sipas standardeve ISO dhe STANAG siç kërkojnë standardet e NATO-s? Sipas praktikave të vendeve anëtare të NATO-s, Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Mbretëria e Bashkuar, apo edhe vendet e rajonit që janë anëtare të NATO-s, si Shqipëria apo Kroacia, procedura për prokurimin e ushqimit për ushtri janë të hapura për publikun, për të garantuar transparencë dhe konkurrencë të lirë.

Prandaj, nëse shtetet e fuqishme ushtarake, si SHBA dhe Mbretëria e Bashkuar, po ashtu edhe vendet tona fqinje mund të ndjekin procese të hapura, atëherë cilat mund të jenë motivet e arsytet që Kosova të veprojë ndryshe?

Përtej aspekteve të transparencës dhe konkurrencës, NATO ka vendosur standarde të qarta dhe të rrepta për ushqimin e forcave të saj, të cilat synojnë t'u ofrojnë ushtarëve ushqim të shëndetshëm, të ekuilibruar, të sigurt dhe të përshtatshëm për nevojat operacionale.

STANAG 2937, standardi NATO për sigurinë ushqimore përshkruan qartë se çfarë duhet të përmbajë një racion për të siguruar që çdo ushtar të marrë kaloritë, proteinat, karbohidratet dhe yndyrat e nevojshme për përballimin e kushteve gjatë operacioneve apo ushtrimeve fushore, por edhe në beteja.

Kur ka operacione me intensitet të lartë, nevojat kalorike edhe mund të rriten. Prandaj, këto shifra nuk janë thjesht numra, por janë jetësore për të ruajtur energjinë, vitalitetin dhe kapacitetet operacionale të ushtarëve në operacione ushtarake, ushtrime apo fushëbeteja.

Dua të theksoj se furnizimi në ushqim për përdorim gjatë ushtrimeve fushore, siç janë 'Meal Ready-to-Eat' apo ushqimi i konservuar ditë i gatshëm për t'u përdorur është po aq i rëndësishëm. FSK-ja duhet të pajiset me produkte që janë certifikuar sipas standardeve të NATO-s.

Në shumicën e shteteve të NATO-s ushqimi i ushtarëve menaxhohet nga kompanitë e specializuara, të cilat janë të njohur për përmbushjen e këtyre standardeve të rrepta. Mungesa e transparencës në procesin e tenderimit, kontraktimi i kompanive të pakualifikuara dhe dështimi

për të ndjekur standardet ndërkombëtare janë një dështim flagrant për të respektuar këto detyrime dhe janë cenim i sigurisë kombëtare.

Të nderuar deputetë,

Qytetarë,

Gjej rastin t'u bëj thirrje edhe një herë Qeverisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes që të evitojnë një qasje jo të duhur dhe jotransparente, sepse kjo qasje jo vetëm që rrezikon shëndetin e ushtarëve tanë, por përfshin pasoja strategjike lidhur me aftësinë tonë për të përmbushur detyrimet ndërkombëtare dhe për të mbrojtur sigurinë kombëtare.

Prandaj, kërkojmë përgjegjësi të plotë nga Qeveria dhe Ministria e Mbrojtjes që të ndërmarrin hapa të nevojshëm për të krijuar standarde të qarta dhe të zbatueshme, duke përdorur ekspertizën e NATO-s dhe përmes një procesi transparent dhe konkurrencës së drejtë t'i japin qasje për garë të drejtë e të barabartë kontraktorëve të dëshmuar dhe me eksperiencë.

Po ashtu, e kam një porosi për ushtarët dhe ushtarakët e FSK-së. Ne e dimë që ushqimi nuk është i vetmi problem. I dimë problemet me veshmbathje, transport, mëditje, rrezikshmëri në punë, banim etj. E dimë si u kërkohet angazhim në shpërputhje me mbështetjen që u ofrohet dhe largimi i theksuar nga Forca e Sigurisë së Kosovës është rezultat i këtyre problemeve. Por keni durim! Ditët më të mira po vijnë. Lidhja Demokratike e Kosovës ka një plan të qartë për ta rregulluar këtë. Nën drejtimin tonë, blerja e ushqimit dhe e shërbimeve të tjera thelbësore për Forcën e Sigurisë së Kosovës do të menaxhohet me profesionalizëm, transparencë dhe parashikim. Ne do të prezantojmë standarde ndërkombëtare për të siguruar që ushtarët tanë të mos lihen më kurrë me një pozitë të tillë të rrezikshme. Kjo ka të bëjë më shumë se thjesht ushqimin. Ka të bëjë me llogaridhënien, transparencën dhe respektin për Forca tona të sigurisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, ftoj kryetarin z. Ramush Haradinaj.

RAMUSH HARADINAJ: I nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Të dashur qytetarë të Kosovës,

Dy shprehje janë përditshmëri në uniformë, pra te ushtarët. E para është ajo që u thotë qytetari i vendit në vazhdimësi, "faleminderit për shërbimin". Pra, qytetarët, të gjithë, pa marrë parasysh profesionin a përkatësinë e caktuar, sa herë që i shohin ushtarët në uniformë, e praktikojnë këtë shprehje: "Faleminderit për shërbimin"!

Ndërsa, ata që u japin urdhra, ata që u japin drejtim punëve në ushtri, i përshëndetin oficerët e nënoficerët e ushtarët me: "Nderime atdheut"! Këto dy fjalë, ose këto dy shprehje shpjegojnë çka është ushtria. Pra, ata që duan ta marrin vesh, që duan ta dinë në shtetin e vet, po ashtu

faleminderit për shërbim vlen edhe për familjet e ushtarëve, për fëmijët e tyre, për prindërit e tyre, për gratë apo burrat e ushtarëve dhe të oficerëve, sepse kur njëri shërben, ai mund të shërbejë një kohë të gjatë pa qenë në shtëpi. Mund të shërbejë natën, mund të shërbejë në zona të rrezikshme.

Pra, zakonisht kur e dimë që është fëmijë i një ushtaraku, të gjithë i thonë faleminderit! Të gjithë të tjerët, sepse është profesion i tillë, pra i shenjtë, i një popullit liridashës. Pra, kur kalon, pra kur e kryen shërbimin në uniformë, një ushtarak, ka plot organizime e asociacione si të trajtohen këta ushtarakë, si t'i bëjnë të ndihen mirë gjatë gjithë jetës së tyre për kohën se sa kanë shërbyer në uniformë.

Ne jemi duke folur për bijtë e bijat tona që shërbejnë në uniformë, por nuk harroj t'i falënderoj ushtarët e NATO-s, ushtarët e KFOR-it, që janë larg familjeve të tyre dhe shërbejnë në Kosovë, e shërbejnë si djemtë e vajzat tona të na ruajnë neve. Pra, u faleminderit për shërbimin!

Sot, po trajtojmë situatën me logjistikën e ushtrisë, me shërbimet. Merre me mend, jemi mbledhur sot, gjashtë vjet pasi është krijuar ushtria, u kthye të flasim për logjistikën, për shërbimet e ushtrisë sonë. Pra, as nuk jemi mbledhur këtu për të diskutuar planin dhjetëvjeçar, sa afër jemi, as nuk jemi këtu për të diskutuar për teknikën, për të tjerat që i duhen ushtrisë sonë, por po flasim për diçka që është logjistike. E logjistikën, ushtritë e botës që mijëra vjet kanë gjetur mënyra ta zgjidhin. Bile-bile, edhe ne në kohë të luftës në UÇK, në situatën tonë e kemi zgjedhur çështjen e logjistikës, të ushqimit, veshmbathjes, mënyrën që kemi ditur duke e bartur me krah, shumë herë edhe ushqimin. Me krah edhe ushqimin.

Ushitari i Kosovës, po edhe polici, ai që shërben në uniformë, ai nuk ka shkuar aty për ushqimin e tij, për ato kushte, për pagën. Është në gjendje të japë nga racioni i vet ditor për cilindo qytetar. Ai ka shkuar të shërbejë deri në frymën e fundit të jetës së vet. Pra, pse kështu? Sepse, ai e ka ndarë, ose ajo, sepse ka edhe vajza që shërbejnë në ushtri, zonja, pra e kanë ndarë mendjen. Ata identifikohen me një karakter të tyre, me një dinjitet të tyre, me një atdhedashuri që vërtet është sublime.

Po Qeveria jonë si është, Qeveria e Kosovës? Si është kryeministri? Kur në këtë foltore herët i kam thënë mashtrues, shumica e njerëzve kanë menduar që buron veç nga opozitarizmi. Ju lutem, angazhimi i tij ditor i tëri është mashtrim. Ai nuk punon në interes të këtij vendi. Ai në mënyrë sistematike, me qëndrueshmëri, pra me vazhdimësi pa ndalur vazhdon ta dobësojë vendin që e udhëheq, t'ia dobësojë shtyllat, shtyllat jetike, shtyllat e sigurisë. Ai godet pamëshirshëm Policinë e vendit, AKI-në, ushtrinë, edhe atë, në mënyrat më të ulëta të mundshme. Edhe vazhdon t'i godasë.

Kur një ditë këtu i kam thënë se ai është spiun i Serbisë, po është spiun i Serbisë. Po është tradhtar ai njeri që e lë ushtrinë e vet pa bukë. Çka tjetër t'i thuhet këtij njeriu? E ka lënë ushtrinë e vet pa bukë ky njeri. Pse e bën ky këtë? Pse po i ndodh këtij? Pse nuk i ndodhi dikujt tjetër gjatë gjithë ekzistencës sonë që njëzet vjet? A të gjitha janë rastësi a? Edhe kjo rastësi qenka, edhe kjo pahiri të mbetet ushtria pa bukë. I ka lënë pa transport, i ka lënë pa veshmbathje, i ka lënë pa shumëçka tjetër. Arriti t'i lërë edhe pa bukë.

Ju lutem, kush e mbron këtë njeri, shiheni çka jeni duke bërë, pra po e mbron njeriun që mbërriti edhe ushtrinë ta lërë pa bukë. Besomëni, nuk i them me ndonjë dëshirë të madhe këto fjalë, se ne jemi të gjithë të këtij vendi, shqiptarë jemi, të Kosovës jemi, po duhet t'ua vëmë emrin. Nëse para gjashtë vjetësh kemi arritur të krenohemi në këtë Parlament se po e krijojmë ushtrinë tonë, që po i votojmë ligjet për ushtrinë tonë, ligje që nuk dallojnë nga ligjet e ushtrive të botës, që po e nisim rrugën tonë drejt NATO-s. Të vihet sot këtu të diskutohet se na i ka lënë ushtarët pa bukë Albin Kurti. Po, është spiun, spiun i Serbisë është, agjent i tyre është, njeri i tyre është, përndryshe kurrë nuk e kishte lënë gjendjen kështu. Edhe kur ndodh një situatë e keqe, prapë ka mënyra në mënyrë urgjente ta thërras Këshillin Kombëtar të Sigurisë e kisha thërritur në gjysmë të natës, shtatë veta i kisha çuar në shtëpi. Kam çuar njerëz në shtëpi për sende më të vogla se kjo. I kisha çuar në shtëpi shtatë vetë, prej një deri në shtatë. E gjatë natës, shtab krize ishte bërë, e s'kishte guxuar kurrë të rrijë ushtari e ushtria pa ato që i takojnë, pa ushqimin.

Ne duhet ta ndërrojmë këtë Qeveri. Aleanca, kolegët që bashkëpunojnë do ta ndihmojnë ndryshimin, sepse e dimë se është interes kombëtar.

KRYESUESI: Tash do të kaloj që t'ua jap fjalën deputetëve sipas radhës që janë paraqitur. Ftoj deputetin Elmi Reçica ta marrë fjalën.

ELMI REÇICA: Faleminderit, zoti kryesues, z. Hoxhaj!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë,

Media të respektuara,

Të nderuar dhe të respektuar ushtarë dhe oficerë të Kosovës,

Pra, është kjo pamje që po ndodh në dy seanca radhazi, ku po debatohet për çështje shumë të rëndësishme, shumë me peshë për vendin dhe jo vetëm për këtë Parlament. Është keq që deputetët e pozitës, që nuk janë sot këtu. Mbajnë konferenca për shtyp dhe arsyetohen se nuk duan të vijnë këtu, sepse këto çështje i kanë diskutuar në komisionet funksionale parlamentare dhe atë me dyer të mbyllura. Ky është arsyetimi i tyre qenësor që është marrë.

Sot jemi mbledhur këtu për të shprehur shqetësimin tonë të thellë ndaj mënyrës si Qeveria Kurti po i trajton ushtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Prej ardhjes në pushtet të kësaj Qeverie, Qeverisë së Albin Kurtit, gjendja në FSK si në të gjitha institucionet e tjera të Kosovës, përfshirë edhe vetë Kosovën, ka shkuar duke u përkeqësuar gjithnjë e më shumë.

Nuk është vetëm çështja e ushqimit. E thanë edhe parafolësit e mi pak më herët që ishin këtu, që çështja e ushqimit nuk do të duhej kurrë të jetë një çështje që të diskutohej këtu. Në kohën kur rreth nesh, po shpesh edhe brenda nesh ka situata që mund të eskalojnë, edhe ka situata kur mund të përkeqësohet gjendja.

A është kjo e rastësishme pse dhe çka po ndodh me ushtrinë tonë, me FSK-në? Unë e kam thënë edhe me një rast, këtu kemi një dualizëm të qartë. Për atë arsye ka përplasje brenda asaj ministrie dhe institucioneve të tjera. E ke Qeverinë e Albin Kurtit me ministrat e vet dhe e ke Dejona Mihalini me komitetet e Vetëvendosjes, që janë ministri paralele. A di çfarë thonë ata? I thonë zëvendësministrit shko ti zëvendësministër, por ti do të jesh ministër. Dhe pastaj atë e konsiderojnë si ministër. Dhe për këtë arsye atje ka rrahje, ka keqpërdorime, ka nxjerrje të vendimeve, dokumenteve që nuk janë të ministrit. Pse iku ministri paraprak që me aq bujë e prezantuan? Për këto arsye. Pse ky ministër është në gjendje shumë të rëndë tash aktualisht? Për këto arsye. Sepse, ai është vetëm pjesa formale.

Nuk është tash vetëm çështja e ushqimit, e ushqimeve. Asgjë nuk them të re, që sa kohë është debatuar këtu, është thënë edhe në studiot televizive që oficerët më të mirë që ka kjo ushtri e kanë braktisur këtë ushtri. Jo për pagë. Oficerët që janë shkolluar në shkollat më elite ushtarake, që kanë pasur nota të jashtëzakonshme dhe në gara kanë marrë vendin e parë. Nuk ka qenë që paga s'është e dinjitetshme, sepse një ushtar, një ushtarak, një oficer, nuk shkon vetëm për një pagë. E di saktësisht se shkon për ta mbrojtur dhe për të qenë në gatishmëri për ta mbrojtur vendin. Ata kanë ikur. Ne e dimë, minimum pesë kapitenë, që secila ushtri dëshiron t'i ketë brenda ushtrisë së vet, shtetit të vet, e kanë braktisur.

Kur ka ndodhur, as në UÇK, as në TKM, as në ushtrinë e tashme, që kur shpallen aplikimet për të konkurruar për ushtarë, mezi që i bëjnë numrat. Raportet gjithmonë kanë qenë një me pesëdhjetë e më shumë. Sot, është bukur problem të gjenden djem e vajza që janë të gatshëm të jenë pjesë e kësaj ushtrie. Kush e ka sjellë këtë ushtri në këtë gjendje? Qeveria e Albin Kurtit.

Me gjithë ato që u thanë e që do të thuhesh edhe në të ardhmen, a ka më keq dhe më rëndë kur një ushtar i ushtrisë sonë detyrohet të mendojë për ushqimin e vet. A e rrezikon sigurinë kombëtare një gjendje e tillë. Pa dyshim që e rrezikon. Në ushtritë e vendeve të tjera, ku ne synojmë të kyçemi, edhe çështjet më të imta trajtohen si rrezikim i sigurisë kombëtare. Këtë ne duhet ta kemi parasysh.

Mund të them edhe shumë çështje të tjera, po në kohën kur nuk është stabile, sepse kjo Qeveri, ky Kryeministër, Albin Kurti e ka lënë pa aleatë që i ka pasur para 27-28 vjetësh, para tridhjetë vjetësh. Ka pasur raporte më të fuqishme me aleatët e tillë, por sot e dobëson fuqinë mbrojtëse të këtij vendi, për shkak të një tenderi dhjetëmilionësh që u duhet tash për zgjedhje. Kjo është e qartë. Beteja për ushqimin e FSK-së ka qenë beteja kush do të vjedhë më shumë për partinë e tyre dhe për veten normalisht.

Kjo sigurisht që është çështje kyçe që ka një ndërhyrje të kësaj natyre edhe në këtë çështje.

Për fund, sepse ne realisht kemi ardhur këtu, jemi mbledhur këtu për ta thirrur këtë Qeveri dhe këtë kryeministër për t'i bërë thirrje dhe për të kërkuar që të merret urgjentisht me këtë çështje.

Në kohën kur në çdo aspekt, kjo ushtri dhe ky shtet nuk është atraktiv për njerëzit tanë, janë përmendur shifra këtu, kurrë më shumë qytetarë tanë nuk e kanë lëshuar Kosovën, përjashto periudhën 24 mars deri 11 prill 1999. D.t.th. në kohën kur këtu ka qenë një luftë jashtëzakonisht e ashpër, kur njerëzit kanë bërë një betejë për jetë a vdekje dhe sot të braktiset vendi, të braktiset ushtria dhe të braktisen ato institucione që do të duhej të shërbenin në situata të caktuara për ta mbrojtur këtë vend.

I bëjmë ftesë shumë serioze që kjo Qeveri t'i lërë anash tenderët e hajnitë, të marrë vendim që ushtarët e FSK-së të kenë ushqim dinjitoz, të kenë uniforma dhe veshmbathje serioze e të domosdoshme, të mendojë seriozisht për çështjet që janë jetike për ta ruajtur dhe fuqizuar atë ushtri. Kjo është një thirrje për një veprim të menjëhershëm dhe do të duhej të reflektojë Qeveria me kryeministrin Albin Kurti, po edhe kolegët tanë deputetë të pozitës do të duhej të ishin ata që do t'i prinin këtij procesi, e jo ta lënë në duart e opozitës. Një çështje që është interes i veçantë shtetëror dhe është çështje me shumë interes për sigurinë kombëtare të këtij vendi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! E ftoj deputetin Abdullah Hoti dhe le të përgatitet Time Kadrijaj.

ABDULLAH HOTI: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit, profesor Hoxhaj!

Sot po diskutojmë një temë shumë të ndjeshme, shumë specifike. Ne jemi pra në fund të mandatit qeverisës të kësaj mazhorance. Ndoshta rendi do të duhej që sot ne të diskutonim për planin dhjetëvjeçar të avancimit të FSK-së në ushtri të rregullt sipas standardeve të NATO-s. Për këtë do të duhej të bisedonim sot. Por, ne sot jemi mbledhur për një temë, nuk po e gjej ndoshta fjalën e duhur për ta përshkruar. Të vijë gjendja që Kuvendi i Kosovës të debatojë për gjendjen e furnizimit me ushqim të ushtrisë së Kosovës është gjëja më absurde që s'i kishte shkuar kujt ndërmend që mund të vijmë në këtë pikë.

Unë po kthehem pak në historinë e shtetndërtimit të Kosovës dhe të ushtrisë së Kosovës që në tridhjetë vjetët e fundit çdo vit ka pasur nga një avancim sado të vogël drejt funksionalizimit të plotë të ushtrisë në Kosovë, duke filluar nga fillimi i viteve '90-a kur e kemi bërë organizimin e parë shtetëror, atëherë kur s'na ka njohur askush. Por i kemi krijuar ato Forcat e Armatosura të Republikës së Kosovës, në kushtet specifike të okupimi sigurisht.

Më tutje, përpjekjet tona janë avancuar në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës dhe kanë organizuar luftën në Kosovë, fillimisht duke mos u njohur si grup i armatosur që lufton për çlirimin e popullit të vet, por duke u quajtur me emërtime nga më të ndryshme edhe nga zyrtarë të aleatëve që sot i kemi, por është dëshmuar pastaj që Ushtria Çlirimtare e Kosovës ka pasur mision shumë fisnik edhe është quajtur me emërtimin e duhur. Dhe, në fakt ka qenë aleate e NATO-s në tokë gjatë bombardimeve të forcave serbe në Kosovë.

Pas luftës ka qenë vizion shumë përmbajtësor i lidershit të atëhershëm të Kosovës që bashkë me aleatët të transformohet Ushtria Çlirimtare e Kosovës në Trupa Mbrojtëse të Kosovës, e mandej në Forcën e Sigurisë së Kosovës. Edhe avancimet e mëtutjeshme deri në vitin 2018 në Qeverinë Haradinaj kur bashkë kemi qenë në pozitë atëherë si Lidhje Demokratike e Kosovës e kemi mbështetur pa asnjë mëdyshje pakon e ligjeve për avancimin e FSK-së në ushtri.

Mandej në vitin 2021 në Qeverinë sa unë kam qenë kryeministër e kemi pasur edhe një moment tjetër krenarie këtu në Kuvend kur kemi miratuar, nëse ju kujtohet, një rezolutë për të dërguar ushtarë të FSK-së bashkë me ushtarët amerikanë në misione paqeruajtëse nëpër botë. Ka qenë një moment krenarie për të gjithë qytetarët e Kosovës.

Jemi bërë bashkë atëherë pozitë edhe opozitë. Pra, shihni, në 30 vjet kemi pasur vetëm avancim sa u përket forcave të armatosura të Republikës së Kosovës drejt një ushtrie sipas standardeve të NATO-s.

Por, në tetor 2024 ne diskutojmë për problemin e furnizimit me ushqim të ushtrisë së Kosovës. Ky është degradimi që i ka ndodhur ushtrisë së Kosovës dhe krejt institucioneve të Kosovës, krejt shtetit të Kosovës gjatë këtij mandati.

E tash më thoni si mund të kemi progres për të qenë pjesë e partneritetit për paqe kur ke lëshime kaq elementare në menaxhimin e institucioneve edhe në kujdesin që duhet të tregohet për ushtrinë e Kosovës.

Në fillim të këtij mandati qeverisë me pompozitet është promovuar Fondi i Sigurisë për mbledhjen e pajisje ushtarake për ushtrinë e Kosovës. Unë nuk jam i sigurt, ndjesë nuk kam informata, por nuk jam i sigurt që as anëtarët e komisionit përkatës parlamentar që mbikëqyrin

Forcën e Sigurisë e dinë sa mjete janë mbledhur në këtë fond edhe sa prej tyre janë shpenzuar dhe sa është pajisur FSK-ja me mjete bazuar në mjetet që janë mbledhur në këtë fond të sigurisë.

Si njëri i financave, i buxhetit, unë disa herë kam reaguar në këtë Kuvend në veçanti kur janë miratuar buxhetet vjetore në katër vitet e fundit. Vit pas viti, buxheti i ushtrisë së Kosovës ka rënë si përqindje produktet e brendshme bruto sipas standardeve të NATO-s që është së paku 2%. Por, tash për shkak të zhvillimeve gjithandej nëpër botë, ky buxhet duhet të jetë dukshëm më i lartë. Ka rënë. Ka trend të rënies në katër vitet e fundit.

Pra, atë që isha duke e thënë më herët, në vend që ne sot të diskutojmë për të rishikuar planin 10-vjeçar, për të mos e lënë plan 10-vjeçar, por për ta bërë plan 7-8-vjeçar, më shpejt t'i përmbushim kushtet e nevojshme të dakorduara me aleatët tanë në kuadër të këtij plani 10-vjeçar në vitin 2018, ne sot diskutojmë për furnizimin me ushqim të ushtrisë.

Të nderuar kolegë,

Gjatë vikendit ka pasur gjithashtu zhvillime të tjera. Ne e kemi pasur një informatë të dhënë nga institucionet e Kosovës edhe të promovuar edhe nga kryeministri i vendit për ushtrinë serbe që ka ardhur afër kufirit me Kosovën, dhe kryeministri e ngriti alarmin. Por, në të njëjtën kohë ai ishte pjesë e fushatës zgjedhore të tij në Gjermani.

Tash, imagjinojeni, e ngrit alarmin për një vend fqinj me tendenca armiqësore ndaj Kosovës, që po e afron ushtrinë afër kufirit të Kosovës, vetë bën fushatë në Gjermani edhe ushtrinë e ka pa ushqim. Unë mendoj që nuk ka koment tjetër për situatën tragjike që është krijuar këto ditë në Kosovë.

Në të njëjtën kohë, presidentja e vendit që është komandante e përgjithshme e Forcës së Sigurisë së Kosovës nuk e ka asnjë reagim. E gjen momentin të premtën ose të shtunën t'i thërrasë në një bisedë ministrin e Mbrojtjes edhe komandantin e FSK-së, pa asnjë përgjegjësi institucionale në atë drejtim.

Të nderuar kolegë,

Mesazhi im i fundit është ky, në tri-katër ditë si opozitë kemi organizuar dy seanca të jashtëzakonshme, e njëra për një çështje që u klasifikua këtu në foltore të Kuvendit si tradhti kombëtare etj, etj, ku mazhoranca koordinohet me njerëz që janë duke u ndjekur nga institucionet e Kosovës dhe në lista të zeza të aleatëve tanë. Koordinohet për agjendën legislative të Kuvendit të Kosovës. Jo për agjendën që përfshinë ato ligje që kërkojnë edhe 2/3 e komuniteteve, po për ligje esenciale që prekin elemente shumë sensitive të shoqërisë në Kosovë, siç janë veteranët e luftës. Dhe, sot e kemi edhe një seancë tjetër për ushqimin e ushtrisë së Kosovës.

Dy seanca të jashtëzakonshme të organizuara nga opozita. Unë kërkoj mirëkuptimin tuaj, por nëse kjo opozitë nuk është e gatshme të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme, veprime brenda rendit kushtetues dhe demokratik që e ka Kosova, për të mbajtur përgjegjës njerëzit që e kanë sjellë situatën në këtë pikë, atëherë nuk e di edhe pse jemi në këtu.

Unë nuk besoj që ne duhet të mjaftohemi as me diskutimet e së premtes dhe as me diskutimet e sotme për të përmbyllur këto seanca kështu siç po i organizojmë. Sigurisht, kjo është forma institucionale e opozitës për të adresuar këto çështje, por ne duhet të jemi të gatshëm si opozitë të ndërmarrim të gjitha veprimet për të mbajtur njerëzit përgjegjës, sepse këta nuk kanë moral politik.

Minimumi i moralit politik në këtë situatë do të kërkonte që të premten të kishim dorëheqjen e kryetares së Grupit Parlamentar të Vetëvendosjes. Sot të kishim dorëheqjen e ministrit të Mbrojtjes dhe komandantit të FSK-së. Të kërkohej nga presidentja përgjegjësia në krejt zinxhirin komandues të FSK-së, nga kryeministri e poshtë se si ka ardhur kjo gjendje. Faleminderit për vëmendje!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Zonja Kadrijaj e keni fjalën, dhe le të përgatitet Haki Abazi.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Kosovës,

Të nderuara media,

Ikja e kësaj mazhorance për të mos dashur që të ballafaqohet me realitetin, është e turpshme. S'e di ku janë ose ku po fshihen nëpër këto situata pas këtyre skandaleve, por me siguri janë diku nëpër zyra duke ngrënë plazma keksa, sepse tash kemi mjaft dhe mjaftueshëm pas heqjes së masave.

Është shqetësuese kjo që po e diskutojmë sot. S'do të donim asnjëri që ta diskutonim sot këtë çështje, sepse është e turpshme kjo që po ndodh në vendin tonë.

E gjithë bota me këtë situatën gjeopolitike të krijuar po investon në sektorin e sigurisë, po investon në ushritë e tyre, po investon në policinë e tyre, dhe çka po ndodh në këtë Qeveri. Në këtë Qeveri po degradohen institucionet e sigurisë, njëjtë siç u degradoi Njësia elita e policisë, njëjtë po degradohet edhe ushtria e Kosovës.

Dikush në këtë sallë dhe shumica prej nesh kemi qenë deputetë, një ish-kryeministër e ka bërë ushtrinë e Kosovës. Plot deputetë kemi votuar dhe ka qenë një prej ngjarjeve më madhore pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës. E kemi ndier në shpirt, e kemi ndier në zemër dhe kemi

votuar pa hezitim. Ka qenë një ngjarje e rëndësishme. Dhe sot, një kryeministër po e shkatërron gjithçka që është ndërtuar me mund që 25 vjet.

Por, pa të rrejt Albin Kurti nuk po mund ta dije se çfarë është rrena. Dhe, tash po shihet nga kjo Qeveri se si ka ardhur në pushtet me të gjitha këto rrena, me mashtrime dhe ende po mundohet pa u turpëruar të vazhdojë që t'i rrejë të gjithë.

Polica është e Kosovës, ushtria është e Kosovës. Ata duhet të trajtohen në mënyrë të dinjitetshme dhe duhet të jetojnë dinjitetshëm. Duhet të kenë paga të mira. Duhet të kenë pajisje individuale, të cilat nuk i kanë shumica prej ushtarëve të FSK-së. Duhet të jenë trajnime. Merreni me mend, kur shkojnë në trajnime, edhe pse dërgohen nga institucioni, mëditjet u paguhen veç për një muaj, ndërsa për muajt e tjerë duhet të paguajnë nga paga e tyre.

Ata me atë pagën e tyre, a ta mbajnë familjen apo t'i paguajnë shpenzimet që i bëjnë në vendin ku kanë shkuar për trajnim. Nuk kanë transport të siguar, dhe çka është më e turpshmjia, sot janë edhe pa bukë.

Dhe, merreni me mend, në periudhat më të vështira, gjatë kohës dhe periudhës së luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, nënat tona, motrat tona janë mobilizuar në mënyrë që ushtari të mos ngelët pa bukë, sepse e kanë ditur se ata janë mbrojtësit e shtetit. Ata janë mbrojtësit e atdheut, njëjtë sikurse janë mbrojtësit e atdheut dhe të shtetit sot policia dhe ushtria e Kosovës.

Andaj, sot do të duhej këtu para përgjegjësive të silltet ose të ishte prezent së paku ministri i Mbrojtjes. Dhe, nëse është i shantazhuar nga këto bandat që po dalin nëpër media, të cilat janë me grupe të caktuar të deputetëve të Lëvizjes Vetëvendosje që i kontrollojnë dikasteret e caktuar, të dalin së paku të tregojnë se nuk është bërë me dëshirën e tyre, në mënyrë që të mos u mbetet vula e përgjegjësive atyre që ndoshta nuk kanë faj.

Andaj, me urgjencë kjo Qeveri duhet të reflektojë dhe duhet t'i trajtojë në mënyrën më të dinjitetshme ashtu siç e meritojnë organet e sigurisë. Duhet të investojmë në polici, duhet të investojmë në ushtrinë e Kosovës.

Merreni me mend, një kryeministër që çdo ditë thotë do të ketë luftë. Atëherë, kush do të luftojë? Nëse jo policia, nëse jo ushtria, a mund të llogarisim ne që këta deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje do të mbrojnë atdheun?! Kjo nuk do të ndodhë.

Kjo që po ndodh është turp. Kjo Qeveri ka ardhur me turp dhe do të ikë me turp. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputet! Zoti Abazi, e keni fjalën dhe le përgatitet Blerta Deliu-Kodra.

HAKI ABAZI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Media,

Qytetarë të nderuar,

Sigurisht që pas një tentimi po duket gati se 2-vjeçar që të abortohet puna e Parlamentit, mua më vjen mirë që megjithatë në seanca të jashtëzakonshme po ekspozohet fakti që këtu nuk ka demokraci, sepse ikja prej Parlamentit nuk është gjë tjetër, veçse ikje prej ballafaqimit me qytetarët. Nuk ka arsye tjetër dhe shpjegim tjetër pse nuk janë këtu deputetët e mazhorancës.

Unë mendoj që pyetja e mediave, pyetja e qytetarëve është, pse nuk janë këtu? Nëse në të kaluarën janë bërë protesta, janë bërë veprime opozitare të cilat kanë tërhequr vëmendjen e qytetarëve për secilën gjë, atëherë pse ndodh një abortim i demokracisë në këtë formë?

Së paku ministri e ka për obligim në rastin e parë të shpjegojë para Komisionit Parlamentar Funkcional për Siguri dhe mandej edhe para qytetarëve dhe Parlamentit se çfarë në fakt po ndodh, që në këtë sektor kaq vital e më të rëndësishmin të mbrojtjes së vendit, të mos ketë spekulime.

A është çështje e luftës së bandave e të korrupsionit në ministri. A është çështje e interesave të individëve. A ka ndodhur që vëllai i deputetit Dugolli të ndryshojë marrëdhëniet e prokurimit, apo është çështje e ligjit. Nëse është çështje e ligjit, atëherë le të vijë këtu edhe le të ndërrohet ligji, le të bëhet në nivelin e ligjit të shteteve të NATO-s ku ne aspirojmë që të sigurohen këto çështje dhe të mos bëhemi gazi i botës, realisht.

Tani, nëse ia keni futur politikën ushtrisë herën e parë në maj 2023 FSK-ja u përjashtua nga Defender Europe '23. Tani prapë me politikë e me interesa, i bie që po degradohet FSK-ja dhe imazhi i saj në një kohë absolutisht kritike të potencialitetit të konflikteve në rajon.

Rrjedhimisht, unë mendoj që s'kemi pasur hapësirë tjetër përveçse të diskutojmë në Parlament për këtë çështje, përkundër faktit që është i padëshirueshëm si fakt që ekspozohet një sektor jashtëzakonisht i rëndësishëm i vendit tonë.

Në fakt, ndoshta edhe duhet ta them qartazi që unë jam i bindur që secili ushtar edhe secili oficer i FSK-së e merr bukën me vete në çantë për ta mbrojtur interesin e këtij vendi, për ta mbrojtur sigurinë e këtij vendi. Kjo çka po ndodh flet për mungesën totale të menaxhimit të institucioneve të Kosovës. Një Qeveri plotësisht e paaftë së cilës i kalojnë tenderët, afatet e kontratave dhe lejon që realisht prej secilës çështje të krijohet problem kaq i madh, e që është për kërdi.

Kjo nuk flet për ushtarët as për FSK-në, kjo flet për ministrin, flet për sekretarin, flet për administratën e kësaj Qeverie, e cila lejon që të krijohen kësi situatash të pakëndshme dhe joserioze përbrenda sektorëve vital, që i bie për secilin sektor të mundshëm.

Unë dua ta vë në spikamë edhe çështjen e Ligjit për inteligjencën ushtarake që është diskutuar në këtë Parlament që disa herë që jashtë-institucionalisht është duke u ndikuar aty që të mund, realisht, të kontrollohet inteligjenca ushtarake nëpërmjet individëve të caktuar në ministri edhe brenda FSK-së, që është gabim plotësisht. Kjo me ndikimin e Dugollit, prapë.

Po kur lejohen këto gjëra të ndodhin dhe në vazhdimësi anashkalohet Komisioni Funkcional, bëhen procese paralele jashtë-institucionale, përfundojmë pikërisht në problemet të cilat po na paraqiten në vazhdimësi. Këtu nuk do të duhej të kishte vend politika, sidomos jo në sektorin e sigurisë, i cili është kryesori për gjendjen në të cilën jemi, ballafaqimin me Serbinë me interferimin e mundshëm të shërbimeve të cilat nuk ia duan të mirën Kosovës dhe duan që gjithë kohës ta paraqesin Kosovën në krizë potenciale që të mos kemi investitorë, që të mos kemi ekonomi stabile, që të mos kemi interesim për kthim të kapitalit në Kosovë.

Këto janë konsekuencat e një procesi, i cili gjithmonë degradon kredibilitetin e institucioneve të rëndësishme të mbrojtjes, gjyqësisë, drejtësisë, sigurisë.

Nuk vjen fukarallëku prej qejfit. Fukarallëku vjen kur nuk je në gjendje ta mbash shtëpinë siç duhet dhe rrjedhimisht vendi nuk është në listën e shteteve që garanton investime dhe garanton zhvillim të qëndrueshëm ekonomik.

Në vazhdimësi kjo Qeveri ka dërguar sinjale krize. Sinjale parregullsie. Sinjale të përplasjes me sistemin e drejtësisë dhe mungesë totale të vizionit se si mund të kalojmë në një normalitetet, i cili do të garantonte funksionim të plotë të institucioneve pavarësisht interesave që mund të kenë individët përbrenda këtyre institucioneve.

Unë mendoj që ne duhet patjetër të vazhdojmë me seanca të jashtëzakonshme, sepse në këtë formë, jam i bindur që qytetarët do ta kuptojnë që tentimi i vetëm i kësaj mazhorance është që të abortojë demokracinë dhe të lejojë strukturat paralele, që s'po dua t'jua përmend më emrat, se i kam përmendur në vazhdimësi, që të merren vendime atje dhe të kapin për veshi ministra dhe sekretarë ministrish që ata të marrin vendime të cilat nuk janë të diskutuara as në komisione parlamentare e as në seanca plenare të Parlamentit.

Rrjedhimisht, i bie që ne nuk jemi shtet demokratik. Këtu është duke marrë vendim dikush që është jashtë institucioneve. Për këtë arsye, jam i bindur që ne kemi tema të jashtëzakonshme; mos-themelimi i Fondit Sovran, mos-themelimi i Bankës Zhvillimore, mos-zbritja e çmimeve të artikujve esenciale, përkundrazi, rritja.

Përdorimi i aseteve të buxhetit të shtetit për manipulim publik, siç është kjo tentimi që t'i rrisin pensionet me nga 20 euro për të manipuluar dhe për ta blerë votën për zgjedhjet e ardhshme.

Tentimi të manipulohet me retorikë dasmash diasporën e Kosovës. Ne duhet të flasim për terma konkret. Për mbeturinat që na kanë ardhur deri të hunda. Për rrugët e pakryera. Për mungesën totale të menaxhimit të ministrive. Në secilën ministri që hyn ke probleme të jashtëzakonshme.

Rrjedhimisht, jo seancat e jashtëzakonshme, por unë mendoj që ky Parlament nuk duhet të pushojë deri në ditën kur i përfundon mandati duke i dhënë llogari të plotë për të mirat dhe për të këqijat qytetarit që i kanë ndodhur në këtë periudhë 4-vjeçare. Faleminderit!

KRYESUESI: Zonja deputete, e keni fjalën. Le të përgatitet Armend Zemaj.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, i nderuar nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar kolegë deputetë të opozitës,

Përfaqësues të mediave,

Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës,

Në fakt është seanca e dytë pas koordinimit të kësaj mazhoranca me Radoiçiqin dhe përjashtimit të veteranëve nga paga minimale.

Është absurde që sot mblidhemi bashkë për të diskutuar, jo vetëm për sfidat e Forcës së Sigurisë së Kosovës, por për të folur për mungesën e bukës në njërin prej institucioneve më kredibile në vend. Do të thotë, është e papranueshme që në vitin 2024 ky Kuvend mblidhet që të flasë për djemtë dhe vajzat e Forcës së Sigurisë së Kosovës, të cilët sot nuk kanë bukë.

Pra, e njëjta Qeveri që i ka lënë pa paga veteranët. E njëjta Qeveri me të cilën policët, Njësia Speciale e Policisë së Kosovës ka vendosur maska e ka protestuar para kryeministrit po për paga, sot i kanë lënë në mëshirën e fatit djemtë dhe vajzat e Kosovës, pasardhësit e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Paramendojeni, kjo ndodh në kohën kur kryeministri në çdo të dytën ditë na flet për luftë e kërcënime të vazhdueshme prej Serbisë. Në kohën kur bota flet fuqizim të ushtrive, debati në Kosovë është se a kanë sot apo a kanë nesër që të hanë ushtarët e Kosovës.

Çohet komandanti i Forcës dhe alarmon për gjendjen e rëndë në të cilën ky institucion është. Na thotë që për shkak të problemeve dhe kushteve të rënda sanitare këta ushtarë djem e vajza rrezikojnë të helmohen dhe se s'kanë bukë, kërkon që të pezullohen të gjitha aktivitetet. Ndërkohë që, Vetëvendosja e ka hallin te tenderët.

Komplet, i madh e i vogël brenda kësaj partie sot hallin më të madh e kanë për tenderë. Këta deputetë që sot po thonë që opozita duhet të reflektojë. Mu këta deputetë sot i kanë përgjegjës vëllezërit e motrat brenda këtij institucioni, sekretarë të cilët bëjnë politika me ushtarët e Kosovës. Sot po kërkojnë që të reflektojë kjo opozitë, e nuk janë në gjendje sot të vijnë dhe të përballen, hiç me neve, të përballen me qytetarëve e Kosovës. Të përballen me ata djem dhe ato vajza që në kohët më të rënda i kanë dalë zot këtij vendi.

Krejt këtu kolegë deputetë e dini vizionin e asokohshëm të kryeministrit për ushtrinë e Kosovës, para katër viteve. Na thoshte mu në këtë sallë që me qeverisjen tonë, thoshte se, shërbimi ushtarak bëhet i detyrueshëm në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira të vendeve të NATO-s. Premtonte shërbim ushtarak tremujor për djemtë dhe vajzat e Kosovës.

E çka kemi sot? Sot, katër vjet më pas, rreth katër vjet, i kemi 400 ushtarë më pak të cilët e kanë lënë ushtrinë, jo për shkak të vullnetit të tyre për t'i lënë uniformat. Për shkak të mungesës së meritokracisë në gradime, sepse vendos vëllai i atij, vëllai i asaj që është sekretar dhe nuk i gradojnë njerëzit të cilët kanë dhënë mund e sakrificë dhe janë trajnuar me vite të tëra në këtë institucion kredibil.

Pra, i kanë lënë pa bukë, e besa edhe pa çizme i kanë lënë. Çizmet ushtarët e FSK-së janë detyruar t'i blejnë me buxhetin e tyre personal. Pra, ushtarët që me vite kanë shërbyer në FSK të largohen, e ky demobilizim vullnetar po ndodh për paga.

Hiç s'po flas unë sot për përjashtimin prej Defender-it e raportet e mëhershëm të këtij kryeministri që ta dëmtojë këtë institucion të rëndësishëm. Deri këtu, kolegë deputetë, kemi mbërrirë si shtet. E tash në krejt këtë hallakamë, çohet kryeministri, nuk i vjen hiç marre, flet para qindra qytetarëve të Kosovës që jetojnë në mërgatë për meritokraci. Thotë që kam vendosur meritokraci, e nuk ka pozita të cilat kanë përkatësi partiake.

Kryeministri thotë që s'kanë përkatësi partiake ata njerëz që sot krejt zullumin janë duke e bërë brenda këtij institucioni që i takojnë kësaj partie, sepse sherri i tyre ushtarët e Kosovës sot kanë mbetur pa bukë. Për shkak të këtyre pozitave partiake për të cilat ai po e rren diasporën. Dhe, më vjen keq që po i rren në formën më brutale të mundshme.

Këqyrni sot kush po bën luftën brenda ministrisë për ta kuptuar bash kjo gjendje në të cilën sot kemi ardhur është rezultat i këtyre emërimeve në çdo institucion.

Kolegë deputetë, këqyrni sot qarkullimet bankare, mujore të këtyre që janë emëruar me meritokraci për të cilët po thotë kryeministri. Këqyrni, të njëjtit brenda një viti blejnë katër banesa. Do të thotë, 732 euro pagë, veç në muajin shkurt ka pasur qarkullim bankar 395 mijë euro. Plus brenda një viti i ka blerë 4 banesa ky njeri për të cilin kryeministri po thotë që është

vendosur me meritokraci, e kjo është e dhimbshme, e rëndë, gjendjen në të cilën ata sot e kanë vendosur ushtrinë e Kosovës. Për mua pamja më e vështirë, më e rëndë, më brutale ka qenë përballja e njësisë elitare, Njësisë Speciale në protestë, por unë s'kam besuar që në vitin 2024 ne mblihdhemi të flasim a kanë bukë sot ushtarët e Kosovës, a do të kenë bukë nesër ushtarët e Kosovës.

Dhe, kjo është e turpshme, këtë e bën vetëm një qeveri që çdo ditë ftohen nëpër prokurori këta njerëz që po flasin për meritokraci e i kanë lënë qytetarët në lloç, sepse s'vijne sot këtu të përballen me neve dhe të përballen me arrogancën e këtij pushteti që deri në pasul vjedh.

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Zoti Zemaj fjala është për ju dhe le të përgatitet Pal Lekaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Kolegë deputetë që jeni sot prezentë,

Media,

Qytetarë të Republikës së Kosovës!

Tashmë është e qartë që kulmi i dështimit katërvjeçar të kësaj qeverie po shihet që është ta lësh ushtrinë pa bukë. Por, ajo çka e karakterizon këtë qeveri dhe çka e rëndon faktin para qytetarëve të Republikës së Kosovës është pafytyrësia dhe papërgjegjshmëria për të pranuar dështimin ose për të reflektuar mbi dështimin, por këta e mbrojnë dështimin, e lartësojnë atë, madje e prezantojnë edhe si sukses.

Shihni vetëm reagimin e sotëm, mungesën e prezencës këtu, komunikatat për shtyp, deri edhe te fotografitë e improvizuara të ministrit të Mbrojtjes gjoja që po ushqehet në atë që quhet “kuzhina të Forcës së Sigurisë së Kosovës”. Kjo është pafytyrësi, mashtrim, dështim, edhe ky dështim duhet të reflektojë mbi kolegët tanë deputetë që kanë ardhur me votën e qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Andaj, pyetja sot është për çka qëndrojnë sot këta njerëz në pushtet? Sepse, katër vjet u dëshmuar edhe si qeverisje e vetëshpallur e shpresës, atëherë kur mbetën fëmijët pa libra, edhe kur mbeti Administrata pa paga, edhe kur mbeti policia pa shtesa, edhe kur mbetën spitalet pa barna e tash na mbeti ushtria pa bukë. Kjo me të vërtetë as nuk është imagjinuar në ambiciet tona për liri, pavarësi edhe shtetndërtim, edhe atëherë kur jemi atakuar, kur jemi sunduar, por edhe atëherë kur jemi vrrarë që të mos ketë ushtri të rregullt edhe ushtri të Kosovës me njerëz profesionistë edhe të artit ushtarak.

Sot, kjo nuk duhet të tolerohet, të pranohet, por as nuk duhet të shihet si një luftë e jona pozitive dhe opozite, por duhet të ketë reflektim mbi ndershmërinë nëse pak ka mbetur ndershmëri. Unë e kam vërejtur këtë fakt se çka do të ndodhë me ushtrinë e Kosovës, nuk po dua ta personalizoj,

por ju kujtohet në vitin e parë kalendarik të buxhetit të Kosovës, ato tabelat kur i lexuam në leximin e parë të buxhetit, kur anëtarë të Kabinetit edhe deputetë që sot flasin për sigurinë në emër të Vetëvendosjes bënë amendament për t'i larguar nga tabelat buxhetore, me arsyen që duhet të klasifikohen si sekret ushtarak, gjoja që t'i fshehim nga Serbia edhe nga aleatët e saj, Rusia, e të tjerët, por prapavija paska qenë diçka tjetër, për tenderë sekretë, për hajni, për korrupsion dhe për tenderomani. Nuk paskan qenë të sinqertë as atëherë në përkrahjen tonë.

Është fakt i pafalshëm që sot diskutohet, siç e thanë edhe kolegët e mi, gjashtë vjet pas transformimit të madh dhe mbështetjes së madhe me 101 vota në këtë Kuvend për ushtrinë e Kosovës. Po ashtu, pas katër vjetëve të vendimit me mbështetje popullore të votës së shqiptarëve këtu për dërgimin e ushtarëve në misione bashkë me partnerët tanë, ata që na kanë mbështetur, e kanë mbështetur dhe vazhdojnë ta mbështesin ushtrinë e Kosovës, SHBA dhe NATO.

Dhe, sot kur flasim për këtë temë, ne nuk duhet që të heshtim, por s'duhet as qytetarët e Republikës së Kosovës të pranojnë këto fakte që e kanë emrin mashtrim. Sepse, unë jam i bindur se askush nuk e ka menduar dhe askush nuk e ka vlerësuar që do ta përjetojë qoftë si anëtar të këtij Kuvendi këtu, edhe si nevojë e diskutimit një çështje që duhej të ishte më se elementare. Domethënë, për ofrimin e shërbimeve esenciale, për administrimin elementar të nevojave të një shteti që pretendon të jetë i integruar në familjen evropiane.

Por, ne kot nuk u kemi thënë "praktikantë", edhe të paaftë, sepse dështimet në nivele të tilla i kemi parë si kurrë asnjëherë në qeverisjet më të këqija të vendeve që edhe ato quhen diktatoriale. Por, kjo është zhgënjyese jo vetëm për qytetarin, është zhgënjyese edhe për ne, sepse rivalitetin do të duhej ta bënim në program, në premtime të domosdoshme të mira, edhe të cilat e avancojnë jetën dhe shërbimin e qytetarëve tanë. Unë i pyes sot edhe ata të cilët kanë përgjegjësi, edhe komandantin e Forcës së Sigurisë, nuk bën të fshehët askush pas të kaluarës historike qoftë familjare, qoftë profesionale.

Nuk duhet të fshihet as ministri i Mbrojtjes, as të improvizojë, as ai mbi të kaluarën e vet në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. Ai sot duhet të dalë dhe të tregojë a janë verifikuar këta kuzhinierë edhe ata njerëz që sot u shërbejnë ushtarëve tanë? A e kanë të verifikuar të kaluarën e tyre që merren prej qendrave të ndryshme dhe na i ushqejmë sot ushtarët dhe ushtaret tona? Çka nëse ndodh një sabotim? Çka nëse ndodh ajo që vërtet të gjithë jemi të vetëdijshëm që Serbia e Rusia e donë këtë popull të përçarë, e donë një ushtri të dobët, e donë popullin në luftë, atë quhet edhe vëllavrasje. Këta duhet të japin përgjegjësi, askush nuk duhet sot fshihet, këta e dinë pse fshihen, sepse i ka fshehur egoja e pushtetit dhe i ka fshehur egoja e tenderomanisë.

Në vend se sot të vihet e të diskutohet po, një njeri i cili 100 mijë euro në ditë i deponon si shërbyes civil në bankat e Kosovës dhe ta trajtojmë këtë çështje këtu në Kuvendin e Kosovës, këta i mbrojnë ata, e mbrojnë, bile i ofrojnë edhe komoditet, sepse komoditeti është ofruar duke

kapur edhe institucione të tjera të pavarura, edhe Agjencinë e Inteligjencës Financiare, edhe Bankën Qendrore, që besa edhe krejt instrumentet e tjera shtetërore.

E, këto janë pasoja të mëdha. Paramendojeni dhe besoni, nëse ne heshtim këtu edhe të tjerët heshtin, ka për të ardhur një moment kur të gjithë do të biem pre e këtij mashtrimi, të kësaj hajnie edhe kësaj varfërie që po i trumbetohet çdo ditë Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Zoti Lekaj, fjala është për ju dhe të përgatitet Rashit Qalaj nga Partia Demokratike e Kosovës.

PAL LEKAJ: I nderuar kryesues i kësaj seance,

Të nderuar kolegë deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Të nderuara media,

Nuk ka moment më të vështirë që sot para qytetarëve tanë ta bisedojmë një çështje kaq të ndjeshme, siç është furnizimi me bukë për ushtrinë tonë. Nuk ka ndjenjë më të keqe për neve, për ata që e kanë sjellë gjendjen në këtë situatë që sot të debatojmë për ushqim, e jo ne të debatojmë, por atë që është esenciale, armatimi, teknologjia, siguria e vendit dhe ja këta hora që s'janë këtu ku na kanë sjellë.

Është vështirë t'i bindim qytetarët e Republikës së Kosovës që sot po debatohet për diçka që është buka e gojës për ushtarët tanë. Turpi më i madh i kësaj qeverie që sot nuk është këtu, i këtyre deputetëve që sot nuk janë këtu, që abstenojnë për çështje kryesore që është siguria, do të thotë ne jemi ata që e kemi sjellë apo këta që e kanë sjellë gjendjen dhe sot pa fije turpi, edhe ndoshta janë duke ngrënë "plazma" keksa që ata sot e kanë furnizuar Kosovën me heqjen e masave. Po nuk ka diçka më të keqe sot që ne japim një mesazh që me të vërtetë ushtari jonë, që janë bijtë e dëshmorëve, që janë luftëtarë të lirisë, sot duhet menduar për kafshatën e gojës. Ja kjo qeveri ku na ka sjellë.

Dhe, sot kryeministri i Kosovës, apo dje, bën mashtrime me mërgatën, me ata që i kanë asetet kryesore dhe aksionarët kryesorë të pavarësisë së Kosovës dhe ai shkon, di t'i mashtrojë që kjo qeveri po punon ndershëm, kjo qeveri nuk ka nepotizëm, kjo qeveri nuk ka punësime të familjarëve, nuk ka korrupsion dhe ja ky kryeministër, siç di të mashtrojë aq në mënyrë perfide dhe t'ua shpërlajë trurin qytetarëve, më besoni që një ditë ndoshta do të vijë koha që ky kryeministër do të shkojë edhe më thellë, do t'i lërë krejt institucionet e sigurisë edhe pa rroba, edhe pa këpucë dhe ja ky kryeministër që para 3-4 vjetëve është krenuar që po e rritin buxhetin e ushtrisë, po e rritin buxhetin për sigurinë e vendit, ja ku e ka sjellë vendin!

Mund t'i them kryeministrit ta ulë kokën dhe që ai njeri që mashtron kaq shumë, çdo qytetar e ka mashtruar për këto katër vjet le të ikë sa më parë dhe më të mos e shohim në këtë karrige, por

këtu qytetarët tanë do ta thonë ata që duhet ta thonë dhe jam i bindur që qytetari ynë ka për të menduar ndryshe dhe ka për t'ia treguar vendin kësaj qeverie, sepse sot në vend që të debatojmë për sukseset e kësaj qeverie, për rrugë më të mira, për shëndetësi më të mirë, për arsim më të mirë, për mirëqenie më të mirë, për mosikjen e qytetarëve tanë, për mbi 200 mijë qytetarë e kanë lëshuar Kosovën dhe ky shkon e krenohet në mërgatë që ky është kryefjala e të mirës së Kosovës. Mund të them lirshëm që ky është kryefjala e turp të Kosovës dhe në asnjë moment qytetari ynë, prapë po e përsëris, nuk duhet ta votojë më. Ja sot i injoron 60% që nuk ia kanë dhënë votën, i injoron tërësisht me mosprezencën. Është dashur bile së paku ministri i Mbrojtjes të jetë këtu.

Është dashur që ai të ballafaqohet jo me neve, por me qytetarët, sepse ushtari ynë është rreshtuar në ushtrinë e Kosovës për ta mbrojtur atdheun, sikur çdoherë dhe sot ushtari jonë të ketë gajle që a do të ketë bukë a jo, është turp për këtë qeveri. Ata, jam i bindur që u vjen shumë keq që ne po debatojmë për ushqimin e tyre, jam i bindur që ata nuk kanë dëshirë të na dëgjojnë këto fjali, sepse ata do të durojnë, se nuk kanë shkuar atje për një kafshatë të gojës, kanë shkuar për ta mbrojtur vendin, për ta mbrojtur atdheun, shtetin dhe për të ofruar sigurinë për qytetarët. Ja ku na ka sjellë kjo qeveri.

Me një fjalë, mund të them që le të jetë e fundit që ne debatojmë për ushqim, për ushtrinë tonë, por pajtoj me parafolësit, ne duhet të jemi si opozitë aktivë që deri në zgjedhje të mos i lejojmë këta këtu që të ulen edhe të rehatohen pa i zgjidh këto çështje që janë me rëndësi të veçantë për vendin dhe qytetarët. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Lekaj! Zoti Rashit Qalaj e ka fjalën dhe le të përgatitet Vlora Dumoshi.

RASHIT QALAJ: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Të dashur qytetarë,

Të nderuara media,

Është hera e dytë që po mbajmë seancë të jashtëzakonshme me ulëse bosh të deputetëve të mazhorancës, me ulëse bosh të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me rezultate bosh.

Të dashur qytetarë,

E di që është e rëndë, e dhimbshme, e papranueshme sot dhe gjatë këtyre ditëve për ju që po dëgjoni këto probleme që i ka institucioni i shenjtë i Republikës së Kosovës, ushtria e Kosovës, uniforma e shenjtë e ushtrisë së Kosovës, e cila është trashëgimtare e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ky Kuvend dhe ky vend ka pasur burra, ka pasur kryeministra, të cilët kanë marrë vendime të mëdha dhe kanë marrë vendime të guximshme. Një vendim i tillë i madh dhe i guximshëm ka qenë demobilizimi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe shndërrimi në Trupa

Mbrojtëse të Kosovës, e cila trupë i shërbeu popullit të Kosovës për vite të tëra duke ngritur kapacitetet, duke zhvilluar dhe duke pajisur me dije pjesëtarët e saj dhe duke shkolluar pjesëtarët në kolegjet e luftës në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në akademitë mbretërore të Britanisë së Madhe e në shumë akademi të ndryshme botërore e ushtarake që janë elitë.

Dhe, po ashtu pastaj u formua ushtria e Kosovës në vitin 2018, pas shumë pengesave, sfidave, por që u mor vendimi dhe u formua ushtria, e cila na bën krenarë të gjithëve, ushtri e cila tashmë është duke përmbushur kushtet operacionale që shpjen drejt standardeve të plota të NATO-s, dhe këto kushte operacionale kërkojnë investim, shkollim, trajnim, pajisje ushtarake dhe mbi të gjitha kërkojnë trajtim të dinjitetshëm të pjesëtarëve të ushtrisë së Kosovës.

Dhe, fatkeqësisht edhe pse Forca e Sigurisë ka arritur një shkallë mjaft të madhe të profesionalizmit, shumë kuadro të saj po dhënë dorëheqje, po e lëshojnë forcën jo nga dëshira, por nga detyrimi për shkak të trajtimit joadekuat, për shkak të mungesës së pajisjeve, të mungesës të trajnimeve, për shkak të mungesës së çështjeve elementare, siç janë uniforma, këpucët, çizmet, për shkak të mungesës të karburanteve që t'i furnizojnë veturat e tyre për trajnim, e kështu me radhë.

Ushtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës nuk kanë rrezikshmëri, edhe pse ata punojnë me armë të rrezikshme, për shembull ushtarët e këmbësorisë përdorin armët e kalibrit 12.7 dhe s'kanë rrezikshmëri, snajperistët s'kanë rrezikshmëri, deminerët, me të cilët mburret ky pushtet, për shkak se kanë arritur në nivelin e profesionalizmit që të trajnojnë edhe ushtarët që janë në luftë në Ukrainë, ukrainasit, ndërsa vetë nuk kanë rrezikshmëri.

Dhe, kjo është arsyeja pse ata po shkojnë, e jo siç na thoshte ministri dhe stafi i tij para disa ditësh në komision, për shkak të bashkimeve familjare e kështu me radhë. Pra, është një gënjeshtër e madhe për shkak se ushtarët tanë po na ikin për shkak të kushteve dhe mirëqenies sociale.

Ky pushtet u kujdes që ta denigrojë në skajshmëri Policinë e Kosovës dhe njësitë elite të saj, duke e dëmtuar rëndë në paga, në koeficient të pagës, duke e dëmtuar rëndë në rrezikshmëri, e kështu me radhë në pajisje e të gjitha pajisjet që i ka. Njëjtë po vepron tash me Forcën e Sigurisë së Kosovës, a thua pse? Në seancën e kaluar të jashtëzakonshme folëm për kërkesat që i ka bërë udhëheqja e Grupit Parlamentar të Vetëvendosjes Simiqit dhe aprovimet që ka marrë nga Radojçiqi, ndërsa këto ditë po e kemi lëvizjen e lirë të komunitetit serb me pasaporta ilegale të lëshuara nga institucionet ilegale të Serbisë. Mendoni që është rastësi? Qofsha i gabuar!

Po ashtu, biseduam për kërkesat që këta i kanë bërë Simiqit e që ato kërkesa ia ka aprovuar Radojçiqi, ndërsa tani ushtria është pa bukë. Mendoni se është rastësi? Prapë po them qofsha i gabuar. Një javë më parë, pikërisht sot një javë e kemi pasur në raportim në komision ministrin e

Mbrojtjes së bashku me stafin e tij dhe në pyetjen time: zoti ministër, a është e vërtetë që e keni klasifikuar tenderin për furnizim me ushqim, ka thënë “po”. Paramendoni pas klasifikimit është dashur dy muaj, iu kanë dashur këtij ministri që të deklasifikohet dhe çka ka ndodhur? Pasi ka kaluar afati ligjor i asaj kompanisë që ka pasur tenderin, kanë autorizuar një komision të negociojë me shtatë kompani, i cili komision ka kryer punën e vet dhe pasi kanë kryer punën e vet u kanë bërë presion që sa më shpejt ta bëjnë raportin, edhe pse afatet ligjore janë përcaktuar në Forcën e Sigurisë, që raporti duhet të shkruhet në afat prej 10 ditëve. Ky raport i është bërë, por që ka qenë raporti i papranueshëm për zyrtarët e lartë në Ministrinë e Mbrojtjes.

Dhe, çka bënë pastaj? Shkruan një tender tjetër, i cili po del tash që është shumë problematik, për shkak se na u tha që aty kanë qenë dy kompani që kanë konkurruar për atë tender dhe në pyetjen time ministrit të Mbrojtjes se a është e vërtetë që njëra nga kompanitë ju ka dërguar email dhe ju ka thënë që unë nuk kam aplikuar në këtë tender, por më janë shfrytëzuar dokumentet në mënyrë të paligjshme, ai tha nuk mund të flas për shkak se është duke u hetuar nga autoritet brenda FSK-së. Pra, nuk e demantoi, po e përsërisë, njëra nga kompanitë u ka dërguar email dhe ka thënë që unë nuk kam konkurruar për tenderin në fjalë dhe nuk patëm përgjigje.

Dhe, sot në konferencën për shtyp njëri nga deputetët koleg yni këtu, tha dhe u mundua të arsyetojë që njëra nga kompanitë ka marrë tenderë për 20 vjet që është e vërtetë dhe i është paguar me miliona që është e vërtetë, por që të njëjtës kompani në Ministrinë e Brendshme, para disa ditëve iu kanë dhënë dy tenderë: njëri në vlerë prej 5,3 milionë për ushqim në Policinë e Kosovës, ndërsa tenderi tjetër ka të bëjë me ndërtimin e një stacioni policor në Veri me vlerë 1,2 milionë. Si është e mundur që për njërin ministri, kompania në fjalë është e papranueshme, ndërsa në ministrinë tjetër i jepen dy tenderë. Pra, çka po fshihet?

Të nderuar deputetë,

Të dashur qytetarë,

Prandaj, ushtrinë e Kosovës po na e lëshojnë të gjitha gradat, ushtarë, rreshterë, rreshterë-majorë të parë, po e lëshojnë majorët, bile majorë që punojnë në punë specifike në Seibor time, ta lëshon majori, eprori më i mirë në ushtrinë e Kosovës, po e lëshon koloneli, ish-atasheu ushtarak në Ambasadën e Kosovës në SHBA po e lëshon punën dhe po shkon të punojë diku tjetër. Për çka? Për shkak të këtyre që i përmendëm më lart.

Prandaj, unë mendoj që kolegët deputetë që sot mungojnë dhe e dini që kanë ardhur nga rruga, sigurisht që duke e parë që data e 9 shkurtit po afron, u duhet kohë që të trajnohen edhe praktikisht që të dalin nga institucionet dhe të shkojnë atje edhe ku e kanë vendin, kanë vendosur ta ushtrojnë daljen nga Kuvendi dhe të qëndrojnë jashtë institucioneve dhe të përgatiten për një opozitë të gjatë, shumë të gjatë. Faleminderit!

KRYESUESI: Znj. Vlora Dumoshi e ka fjalën dhe le të përgatitet Albana Bytyqi.

VLORA DUMOSHI: I nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Të dashur qytetarë,

Kjo është seanca e dytë që mazhoranca nuk merr pjesë për dy tema të rëndësishme që e prekin sigurinë tonë kombëtare të Republikës së Kosovës.

Unë po ju drejtohem me pyetjen: ku jeni, o frikacakë, pse nuk jeni sot këtu?

Kjo Qeveri dhe ky pushtet i mashtrimit ka dështuar, se nuk di të drejtojë punët e brendshme të shtetit, sikur edhe ato të jashtme. Në ndërlidhjen e votave të mashtrimit, që bëhen për katër vjet, që nuk tregoi asnjë rezultat të prekshëm, por vetëm lavdërohen çdo ditë.

S'është e paarritshme që së shpejti do t'i dëgjojmë të lavdërohen se si rrezikuan ushtrinë duke e lënë edhe pa bukë. Konstatimi i parë që mund të them këtu është se Ushtria e Kosovës nuk e meriton një Qeveri, institucionet dhe shumicë parlamentare që e rrezikojnë atë të ketë apo të mos ketë ushqim. Çdo qeveri normale do të ndërmerre masa që kjo të mos ndodhë. Çdo qeveri së paku normale dhe me një minimum të etikës ligjore dhe njerëzore do të vinte para përgjegjësisë njerëzitet që e sollën vendin deri në këtë situatë, apo siç thotë populli, "në këtë derexhe".

Shqetësimi për këtë situatë i komandantit të FSK-së në letrën e dërguar Ministrisë së Mbrojtjes, ashtu si e lexova, u interpretua nga ky i dyti si komunikim normal. Komunikimi normal është komunikim me gojë e me shkrim brenda institucioneve, por problemi qëndron se situata nuk është normale. Faktet nuk janë normale, rrezikimi i ushtarëve të mbeten pa bukë, për të cilat shqetësohet Komandanti i FSK-së, nuk mund t'i konsiderojmë si çështje normale.

Duhet të jesh pushtet jonormal për të trajtuar një normale që të mbesin ushtria pa ushqim. Si duket dikujt po i konvenon që të përfitojnë nga konvertimi i një tenderi të rregullt dhe ligjor në atë të negociueshëm.

Deputetë të nderuar,

Nuk po rrezikohet ushtria të mbetet pa ushqim, të rregullohet dhe cilësor, sepse vendi nuk ka buxhet, as sepse vendi nuk ka ligje që e rregullojnë mënyrën e tenderimit të furnizimit me ushqim, as sepse Qeveria nuk mundur të investojë e të krijojë kapacitete të veta të prodhimit të ushqimit për ushtrinë, policinë, spitalet dhe shkollat, por u rrezikua nga korrupsioni, nga fakti se siç potencuan mediat, dikujt brenda ministrisë i konvenon që ushqimi të shpallet çështje sekrete, ashtu siç kjo Qeveri shpalli gurët dhe zallin, tullat dhe asfaltin dhe arritën që mbi 2175 kontrata t'i bëjnë me negociim. Negocimi për korrupsion, por jo të kryejnë punët, jo për ta zhvilluar vendin.

Ky Kuvend duhet të informohet se me fajin e kujt erdhën në këtë situatë me bukën e ushtrisë sonë. Ky Kuvend duhet të ndërmarrë masa ndaj atyre që e sollën ushtrinë tonë në këtë gjendje. Ky Kuvend duhet t'u tregojë Qeverisë dhe institucioneve të larta të shtetit, të cilat janë përgjegjëse e të cilat e kanë çdo ditë gojën plot luftë, herë me Rusinë, e herë me Serbinë, e me këto sjellje atyre po u tregojnë që jemi aleatë të tyre e jo kundërshtarë. Sepse, vetë Qeveria dhe institucionet e vendit po e luftojnë ushtrinë tonë, djemtë dhe vajzat e këtij vendi.

Ky Kuvend duhet t'i tregojë Qeverisë se me këto sjellje, me këtë paaftësi të papërgjegjshme duhet të japë dorëheqje, duhet të shkojë në shtëpi.

Kosova nuk e meriton që të rrezikohet deri në këtë nivel dhe askush të mos lëvizë vendit e të mos marrë masa. Pyetja shtrohet: pse disa individë në Ministrinë e Mbrojtjes dhe në Qeveri qenkan më me vlerë e më të rëndësishëm se krejt ushtria e Kosovës dhe cilat interesa këtu po thyhen?

Kjo sjellje do të na çojë që situata të tilla të kemi nesër edhe në institucione të tjera, sepse dikush nuk ka turp, as nuk frikësohet nga përgjegjësia të abuzojë edhe me bukën, miellin, vajin, ujin dhe këto abuzime i bëjnë në emër të numrit të votave. Votat nuk i keni marrë t'i abuzoni, sepse besoj shumë se ata që ju kanë votuar nuk mund të jenë abuzues, por ju abuzuat dhe po abuzoni me besimin e tyre.

Mosndëshkimi, mosmarrja e përgjegjësisë të individëve që po e shkelin ligjin, shkelin Kushtetutën, është bërë përditshmëri e kësaj Qeverie dhe e këtij pushteti. Mund të thuhet se është bërë një platformë e Qeverisë së korrupsionit.

Sulmet ndaj institucioneve të drejtësisë për masat që po i ndërmarrin kundër korrupsionit, po bëhet sepse kjo nuk po i pëlqen partisë në pushtet, që t'i prekin njerëzit e saj.

Në fund, situata nuk është e pazgjidhshme. Institucionet e përgjegjshme duhet të vlejnë në çdo rast. Ndërkaq, nëse bash s'keni dije se si të ushqehet ushtria, e kemi një ushtri aleate këtu, NATO-n dhe KFOR-in, ju tregojnë dhe ju udhëzojnë se si të bëhet dhe kryhet kjo punë. Po, ju me korrupsion dhe abuzime, këtë punë ia keni filluar që nga fillimi i mandatit tuaj. Faleminderit!

KRYESUESI: Znj. Albana Bytyqi dhe le të përgatitet Bekim Haxhiu.

ALBANA BYTYQI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë,

Sot, si mund ta justifikojmë një situatë ku ushtarët tanë, ata që e kanë shndërruar trupin dhe shpirtin e tyre në mburojë për këtë vend, janë lënë pa ushqim të mjaftueshëm, pa uniforma, pa çizme të përshtatshme.

A është e vetëdijshme kjo Qeveri për poshtërimin që po ua shkakton këtyre burrave e grave të guximshme? A janë të përgjegjshëm për plagën që po i hapin shpirtit të kombit tonë. Ky është një alarm i rremë e i madh për të gjithë ne.

Të lësh ushtarët pa bukë është një akt i pafalshëm. T'u mohosh atyre të drejtën për të pasur uniforma dhe pajisje të duhura, është të mohosh vetë sovranitetin e këtij shteti. Ushtari i Kosovës nuk meriton të jetë një viktimë e papërgjegjshme qeveritare. Ai meriton respekt dhe përkrahje totale nga të gjithë ne, por mbi të gjitha nga një Qeveri që është betuar të mbrojë interesat e tij dhe të shtetit.

Megjithatë, çfarë ka bërë kjo Qeveri? Në vend që të përmirësojë jetën e ushtarëve tanë, ka krijuar një krizë që shkon përtej kufijve të mungesës së ushqimit. Ky është një sulm ndaj moralit të tyre. Çdo ushtar që nuk trajtohet me dinjitet, humb besimin në misionin që e ka zgjedhur me krenari. Kur bie morali i ushtarëve, bie edhe morali i kombit.

Sot, përveç ushtarëve që vuajnë në heshtje, të rinjtë tanë e shohin me zhgënjim dhe pyesin veten: a ia vlen të bashkohemi me Forcat e Sigurisë së Kosovës, ku Qeveria jonë nuk kujdeset për ata që tashmë shërbejnë? Çfarë mesazhi u dërgohet brezave të ardhshëm? A do të ketë nesër të rinj që do të duan të sakrifikojnë për një shtet që nuk i respekton dhe nuk i mbrohet as at që sot mbajnë barrën e mbrojtjes së vendit.

Qeveria aktuale ka dështuar jo vetëm në politikat e brendshme dhe të jashtme, por edhe në detyrën më themelore të saj, të kujdeset për ushtarët tanë. Dhe kjo është diçka që nuk mund të falet.

Po dëmtohet imazhi i Kosovës në arenën ndërkombëtare, po bie kredibiliteti i institucioneve tona dhe, për fat të keq, po shkatërrohet fryma e atyre që qëndrojnë në vijën e parë të mbrojtjes së vijës. Çdo ditë që kalon pa adresuar këtë problem serioz, është një ditë ku ne dështojmë t'i japim ushtarëve tanë respektin dhe mbështetjen që e meritojnë.

Të dashur kolegë,

Nuk mund të lejojmë që kjo Qeveri të vazhdojë të shkelë mbi dinjitetin e ushtarëve tanë. Ata janë thjesht numra në statistikat qeveritare. Ata janë njerëzit që e mbrojnë këtë tokë me jetët e tyre, ndërsa Qeveria jonë i tradhton me veprime të papërgjegjshme.

Kërkoj nga ky vend dhe nga ky Kuvend që të bëjmë atë që Qeveria ka refuzuar të bëjë, të rikthejë respektin për ushtarët tanë, të përmirësojë gjendjen e tyre dhe të sigurojmë që kurrë kjo të mos përballet me një turp të tillë.

Ne duhet të tregojmë përgjegjësi, të japim llogari dhe të veprojmë që tani.

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Zoti Bekim Haxhiu dhe le të përgatitet Driton Selmanaj.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës,

Vërtet dëshira jonë, e të gjithëve këtu sot pa dallim, dhe e qytetarëve të Republikës së Kosovës, do të ishte të flasim për sukseset e Forcës së Sigurisë së Kosovës, për një lajm të mirë drejt anëtarësimit të FSK-së në NATO, por për fat të keq, keqqeverisja, korrupsioni, hajnia dhe tenderomania ka përfshirë edhe institucionin më kredibil të Republikës së Kosovës të vlerësuar nga vetë qytetarët.

Për ta kuptuar pse ushtarët janë pa ushqim, Qeveria duhet të përgjigjet. Pse tenderët për furnizim të FSK-së i ka marrë nga Ministria e Mbrojtjes, kur ata në të kaluarën janë udhëhequr nga Forca e Sigurisë së Kosovës, e cila posedon tërë administratën e nevojshme për t'u udhëhequr në mënyrë profesionale këto blerjet e ushqimit, ndërtimit të kazermave dhe armatimit.

Po u referohem të dhënave zyrtare nga buxheti i Kosovës me shifra. Sepse, ka edhe çështje të cilat deputetët e mazhorancës mundohen të arsyetojnë, por në krahasim me buxhetin e vitit 2021 dhe vitit 2024, rritja e buxhetit në përqindje bazuar në buxhetin e miratuar për ushtrinë është vetëm 1,8 për qind rritje konform rritjes së buxhetit dhe asgjë më shumë. Pra, kjo është një përqindje e zbatuar krahasuar me rritjen e buxhetit prej asaj periudhe kohore.

Të nderuar kolegë deputetë,

Për ta kuptuar pse dhe si ka ndodhur kjo, duhet t'i shikoni faturat buxhetore. Në vitin 2021, në buxhetin e Forcës së Sigurisë së Kosovës janë 79 tabela dhe projekte të publikuara. Në buxhetin e vitit 2024 janë shtatë tabela të projekteve të publikuara në tabelat buxhetore.

Nëse ju kujtohet, kur është miratuar buxheti i vitit 2024, deputetët e mazhorancës, bashkë me Qeverinë kërkonin që të futen të gjitha projektet me nga një emërtim. Për çështje të sigurisë, thoshin ata. Po nuk paska qenë për çështje të sigurisë. Paska qenë për çështje e hajnisë.

Për çfarë sigurie kanë folur këta? Hajni, të vjedhin në ushqim, në armatim e në ndërtim të objekteve e të kazermave të ushtrisë. Ata që vjedhin bukën e ushtarëve, ata që vjedhin në rezerva

shtetërore, ata që vjedhin në ujë, nuk e kanë vendin në institucione të Republikës së Kosovës. Ata e kanë vendin në burg.

Të nderuar kolegë deputetë,

Albin Kurti ka pasur dëshirë ta imitojë Zelensky-n. Ju kujtohet se si e emitonte duke e veshur një bluzë si Zelensky. Por, punën me ushtri, Kurti në krahasim me Zelensky, është shndërruar në simbol të hajnisë, e mbrojtës i hajnave. Zelensky në luftë u siguron ushtarëve edhe ushqim, edhe armatim. Albin Kurti në paqe nuk po arrin ta bëjë një gjë të tillë, për shkak të hajnisë e tenderomanisë.

Përjashtimi nga Defender 2023 ishte një goditje në arenën ndërkombëtare për FSK-në, por skandali i publikuar i hajnisë me ushqim, është goditje në palcën kurrizore të ushtrisë së Kosovës, është goditje në motivin e ushtarëve të Ushtrisë.

Kjo shpërfaq qasjen e Qeverisë Kurti për të rrënuar kredibilitetin dhe integritetin institucional dhe moralin e vet ushtarëve të Ushtrisë së Kosovës dhe të kësaj ushtrie që është vlerësuar me notën më të lartë nga të gjithë qytetarët e Kosovës dhe vlerësuar edhe nga partnerët ndërkombëtarë si ushtri profesionale.

Se e ka arritur këtë qëllim Kurti, kjo prezantohet me shifra konkrete për numrin e ushtarëve dhe oficerëve të larguar nga Forca e Sigurisë së Kosovës ndër vite. Unë po jua jap këto të dhëna zyrtare: Në vitin 2020, ushtarë që e kanë lëshuar në mënyrë vullnetare dhe që janë pensionuar parakohshëm për shkak të pakënaqësive e çështjeve të tjera brenda FSK-së janë 32. Në vitin 2021 janë 52, në vitin 2022 - 139, në vitin 2023 - 149 dhe në vitin 2024 - 169 ushtarë e kanë liru FSK-në.

Pra, nëse brenda dy vjetëve ky numër ka qenë 84, në vitet e tjera e tejkalon edhe dyfishohet e trefishohet largimi i ushtarëve të FSK-së për shkak të kësaj goditjeje. Duke e njohur gjatë Albin Kurtin, ai nuk e njeh funksionimin e ushtrisë. Atë njëherë e ka shikuar si votë, ndërsa tani po e shohin si tenderë.

Të nderuar kolegë,

Kur lufta kishte filluar në Kosovë në vitin 1998, zjarret e luftës ishin përhapur kudo në Kosovë, dhe pas betejës së Likoshanit, betejës së Prekazit e të Gllogjanit e shumë betejave të tjera në Kosovë, Albin Kurti ishte angazhuar për të organizuar workshop në Prishtinë. Unë po jua prezantoj librin e Howard Clark, i cili e përshkruan luftën civile dhe rezistencën civile në Kosovë. Aty në fq. 157 mund të lexoni se si Albin Kurti organizonte në atë periudhë kohore workshop për rezistencën aktive si një alternativë kundër luftës së armatosur.

Të kthehem prapa në histori dhe e di që në qershorin e vitin 1998, kam qenë diku në kufirin shqiptaro-shqiptar duke sjellë armatim për ushtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Në atë periudhë kohore, me vullnetin që e kishim për të arritur lirinë dhe çlirimin nga Serbia, lëre që nuk diskutohej më çështja e ushqimit, por çështja ishte si të siguronim armatimin. Si është e mundur që një komandant i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës me 124 ushtarë arrin të sigurojë ushqimin edhe për tridhjetëmijë civilë që strehoheshin në malet e Brusit e të Leskës mes Mitrovicës e Skenderajt, e sot nuk ka mundësi që një çështje e tillë të ndodhë në institucionet e Republikës së Kosovës ku ka buxhet. Nëse ka buxhet, pse ushtria është pa bukë? Sepse ka hajni. Hajnia e ka lënë ushtrinë pa bukë. Ushtarët sot janë detyruar të dalin të hanë ushqim jashtë kazermës dhe gjashtëmbëdhjetë prej tyre janë dërguar në komision disiplinor pse kanë dalë të ushqehen jashtë kazermës, sepse ushqimi brenda ka qenë i papërbalueshëm dhe i pamjaftueshëm për ta.

Të nderuar kolegë deputetë,

Tani, kjo është vetëm një pjesë e asaj që është bërë publike, e hajnisë. Po, ka këtu hajni edhe më shumë, që asnjëherë nuk është bërë publike. Prandaj, e ftoj Prokurorinë të merret me këto. E ftoj ish-ministrin Armend Mehaj të bëjë publike arsyen e vërtetë të dorëheqjes së tij.

Fondi që u krijua për ushtrinë nga Qeveria Kurti asnjëherë nuk u bë publik, jo vetëm sa mjete ishin në të, po as si u shpenzuan. Qytetarët dhanë mjetet e tyre për të kontribuar për ushtrinë e Kosovës. Këta shkojnë e vjedhin edhe në pasul edhe në bukë të ushtarëve. Këta kanë vjedhur edhe në armatim. Këtë përgjigje duhet ta japë ministri Armend Mehaj me arsyen e vërtetë pse ai ka dhënë dorëheqje dhe konfliktin që e ka pasur brenda Ministrisë së Mbrojtjes me këta eksponentë kriminalë që vjedhin edhe në armatim, edhe në ushqim, edhe në ndërtim të kazermave.

Kjo çështje është e thellë për hetim të Prokurorisë, sepse njëjtë këta kanë bërë edhe me fondin për COVID. Ju kujtohet që kërkonin mjete për COVID, e në anën tjetër vidhnin edhe në thasë të kufomave. Ata që vjedhin në thasë të kufomave, e në maska e doreza, e që vjedhin bukë të ushtrisë, e në armatim, e ndërtim të kazermave të ushtrisë, ata nuk e kanë vendin në institucione. Këta e kanë vendin në burg, prandaj e ftoj Prokurorinë që të merret me këtë çështje. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Të falënderoj zoti deputet! Ka një ndryshim, znj. Valentina Bunjaku-Rexhepi del para Driton Selmanajt. Le të përgatitet Shemsedin Dreshaj.

VALENTINA BUNJAKU-REXHEPI: I nderuar kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë të opozitës,

S'di a ka më mjerim se kjo pamje. Mjerim edhe kur bashkëpunojnë me serbë. Mjerim edhe kur duhet të flasin e të bashkëpunojnë me opozitën për FSK-në. Kjo pamje seriozisht është trishtuese, edhe janë frikacakë. Sa për frikacakë, nuk e kanë pasur vendin në Qeveri.

Kanë shfrytëzuar mbi pesëdhjetë për qind të qytetarëve, të cilët i kanë votuar, kanë ardhur ta udhëheqin shtetin dhe tani po bëjnë hajgare me shtetin dhe me dinjitetin e qytetarëve të Republikës së Kosovës, në këtë rast me ushtarët FSK-së.

Janë frikacakët, prandaj ne po flasim për qytetarët. Unë mendoj që çdo i dyti a i treti e ka votuar Lëvizjen Vetëvendosje në bazë të rezultatit që e kanë pasur në zgjedhjet e fundit dhe tani po bëhen katër vjet dhe jam e bindur që edhe ushtari, edhe polici, edhe qytetarët, të cilët i ka quajtur analfabetë, janë vetëdijesuar se kjo Qeveri është Qeveri e mjerimit, Qeveri e dështimit dhe Qeveri e thjesht praktikantëve, të cilët nuk dinë të udhëheqin me shtetin.

Po blejmë dronë për ushtri. Shumë mirë që po blejnë, por ata ushtarë për të përdorur dronët duhet thjesht të kenë një motiv. Së paku, duhet të kenë ushqim, sepse ushtarin e mban motivi dhe e mban profesionalizmi, ushqimi i mirë dhe cilësor. Krejt kjo luftë tani që po bëhet dhe që kanë mbetur ushtarët tanë pa bukë, është lufta për tenderë. Jam e bindur dhe kam njohuri të sigurt se sekretarin të cilin e kanë zgjedhur tanimë vëllain e një deputeti, Gafurr Dugolli, ka ndërhyrë Shemsi Sylja, ku unë kam dokumentacion shtesë që edhe përmes mesazheve dhe e-maileve ka ndërhyrë që të zgjidhet sekretar i ministrisë z. Dugolli, me bindjen sepse edhe pasuli kur ka qenë në tenderim, për ta nxjerrë tenderin të cilin ka thënë Shemsi Sylja, është caktuar sekretar Enver Dugolli.

Kjo nuk di çka të flitet më lirë, më drejt dhe më korrekt para qytetarëve që është kjo Qeveri, e cila është e thirrur që s'do të ketë korrupsion dhe tani po lulëzon korrupsioni gjithmonë dhe gjithherë dhe karshi qeverive të tjera janë në kulm të korrupsionit. Tani është momenti i duhur që ta ftojme Prokurorinë Speciale, kryeprokurorin e Speciales që të merret konkretisht me këtë qasje dhe me këtë situatë të krijuar në ministri, dhe që ushtarët tanë kanë mbetur pa bukë.

Tenderët është mirë të jenë tenderë të publikuar, jo tenderë sekretë, tenderë njëburimorë, sepse janë mbushur ministritë me tenderë njëburimore dhe tani çka i thonë kësaj tjetër, pos korrupsion.

Duhet të zgjidhet një kompani që ka kredibilitet, që s'ka skandale dhe që dërgon ushqim cilësor për ushtarët tanë. A janë të njëjtit këta Lëvizja Vetëvendosje, edhe kur ka ardhur Ligji për vlerat e luftës së UÇK-së kanë ikur prej sallës dhe e kanë lëshuar sallën, sepse s'kanë zemër shqiptari dhe s'kanë dinjitet për ta mbrojtur policinë, ushtrinë dhe qytetarët e Republikës së Kosovës.

Kanë ardhur në pushtet me kauza të rrejshme dhe po përfundojnë me skandale. Unë mendoj që kjo është Qeveri e gangsterëve. Është marre që një ushtar të mos ketë ushqim dhe ata të fitojnë milionë, të blejnë banesa dhe thjesht të pasurohen brenda natës.

Prandaj, ne këtu po flasim për qytetarët dhe po i lus të gjithë ata të cilët e kanë besuar këtë Qeveri, të mendojnë me kokë të ftohtë, bile ta mendojnë se si ndjehet një ushtar pa bukë, pa veshmbathje dhe pa dinjitet. E lus Qeverinë, edhe këtë tre muaj apo katër sa i ka mbetur, t'i trajtojë ushtarët me dinjitetet, sepse e meritojnë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Fjalën e ka Shemsedin Dreshaj dhe le të përgatitet Abelard Tahiri.

SHEMSEDIN DRESHAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuara media,

Qytetarë të vendit,

Vërtet është një ditë e rëndë kur pas 25 vjetësh të debatojmë për çështjen e bukës së ushtarit. Kjo tregon se vendi është në rrezik si asnjëherë pas vitit 1999.

Janë cenuar segmentet më të ndjeshme të shtetësisë dhe jo vetëm nga armiqtë që i dimë, por edhe jashtë, por edhe nga brenda, nga jugonostalgjikët!

Pretendimet që të shkatërroni, përluni, ofendoni forcat e sigurisë së vendit, kurrë nuk do të realizohen! Ata djem dhe vajza janë të betuar për mbrojtjen e vendit deri në sakrificën sublime, pa ujë, pa bukë, pa uniforma e pa veshmbathje.

Këta janë djemtë dha vajzat që shqiptarëve ua mundësojnë gjumin e qetë dhe të sigurt. Qeveri, ju nuk keni buxhet për bukën e ushtarit, por keni miliona për udhëtime jashtë vendit.

Me ardhjen tuaj në pushtet, i drejtohem pozitës aktuale, ju quajta të kuq, nuk reaguat. Ju quajta levantinobolshevik, e pranuat. Ju krahasova me Qaveza dhe diktator të tjerë, heshtët. Heshtja është pohim! Premtuat bashkim kombëtar! Premtuat “hajnat në burg”! Premtuat ushtri të rregullt! Premtuat forcë rezervë të mbrojtjes! Premtuat lëndën e “Mbrojtjes dhe Sigurisë “ në shkolla të mesme! Premtuat e çfarë nuk premtuat deri më sot!

Por çfarë bëtë? Bashkimin kombëtar, po e realizuat me Radoiçiqin! Hajnat i mbrojtët.

Ushtrinë e rregullt leje që nuk e krijuat, por FSK-në e keni lënë edhe pa bukë! Forca rezervë e mbrojtjes kurrë më nuk u përmend! Lënda e “mbrojtjes dhe sigurisë” në sirtarët e MASHTI-it!

I drejtohem kryeministrit. Kryeministër, e mashtrove elektoratin, qytetarët, mashtrove të burgosurit politikë, të cilët ju dhanë draftin në hard copy, për sigurinë e vendit. Kryeministër, nuk ke lënë asnjë premtim pa e shkelë, por tre veprimet e fundit: negociimi me Radoiçiqin për veteranët dhe invalidët e UÇK-së, ushtarët pa bukë, si dhe lirimi i hyrjes së mallrave serbe në Kosovë janë kulmi.

Do ta përmend thënien e Anne-Marie Lizin, të cilën e vrau pushteti serb, po citoj: “Edhe nëse ajri i pastër të vinte vetëm nga Serbia, dhe jeta ime të ishte e varur prej tij, po të isha shqiptare, kurrë nuk do ta blija”. Këto veprime nuk duhet të kalojnë pa ndëshkim.

Dorëheqja si akt moral është më së paku çka mund të bëhet nga ministrat e linjës. Për 150 vjet jemi vrarë për këtë vend, e besa-besë edhe shumë nga ata që sot nuk janë këtu janë vrarë për Kosovën e lirë!

Nëse duhet ushtari që të vritet prapë, edhe unë do t'i bashkëngjitëm dhe do të vdesim sërish për këtë vend, se unë nuk kemi atdhe alternativ.

Ju që keni alternativa, të mos i sakrifikoni dhe mos e shkatërroni ushtrinë. Në demokraci thuhet vota është plumb. Thellë jam i bindur që më 9 shkurt do të vetëdijesohet i tërë opinioni, votuesi, dhe këtë Qeveri do ta dërgojë në shtëpi. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Fjalën e ka zoti Tahiri.

ABELARD TAHIRI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe dy muaj e shënojmë 6-vjetorin e themelimit të ushtrisë së Kosovës. Në prag të këtij përvjetori do të doja shumë që sot ta përgëzoja Qeverinë e Kosovës për sjelljen e raketave Javelin në Kosovë, të cilat janë porositur nga ish-ministri i Mbrojtjes, zoti Rrustem Berisha. Por, fatkeqësisht në 6-vjetorin e themelimit të ushtrisë së Kosovës, ne po diskutojmë për mungesën e ushqimeve dhe gjërave elementare në ushtrinë tonë. Për besë, edhe e mjerueshme edhe e turpshme.

Të nderuar kolegë deputetë,

Gjatë këtij mandati qeverisës nuk është që nuk kemi pasur respekt dhe që nuk i kemi kursyer anëtarët e Kabinetit qeveritar, duke filluar nga kryeministri dhe ministri e tjerë, me përjashtim të një ministri. Pra, si opozitë e kemi respektuar dhe i kemi nderuar jashtëzakonisht shumë si ish-ministrin e Mbrojtjes që ka qenë para tij, zotin Mehaj, si ministrin e tanishëm, zotin Maqedonci.

Kemi heshtur përballë shumë pakënaqësive dhe shumë parregullsive, të cilat i kemi parë në vazhdimësi. Ja, po ju tregoj në raport me çka kemi heshtur. Kemi heshtur kur e kemi parë qysh

klasifikohet si sekret të blihen kamionë në vlerë 4 milionë euro. Unë e kuptoj që duhet të blihet armatim, mjete të blinduar në mënyrë të sekrete, por nuk e kuptoj si duhet të blihen kamionë në mënyrë sekrete në vlerë 4 milionë euro kur i ke më shumë 20 kompani të Kosovë që të shesin kamionë, por nuk i kem kompani që të shesin mjete të blinduara.

Për këtë kemi heshtur. Edhe pse e kemi parë që s'është në rregull, prapë kemi heshtur. Kemi heshtur edhe kur e kemi parë qysh e blejnë sistemin mobil për dezinfektim rreth 300 mijë euro me procedurë sekrete. Jo me tender njëburimor, sepse tenderi njëburimor prapë bëhet me procedurë të prokurimit, por procedurë sekrete, ku nuk e sheh askush, as nuk auditohet nga auditori.

Pra, atë dezinfektimin që na e bën komuna çdo vit, që e shohim, këta e blejnë në mënyrë sekrete.

Të nderuar kolegë deputetë

Kemi heshtur edhe atëherë kur e kemi parë qysh klasifikohet si sekret blerja e veshmbathjeve dhe pajisjeve dhe të aksesorëve të ndryshëm në vlerë prej 3 milionë e 500 mijë euro, që zakonisht në të kaluarën janë blerë me oferta të hapura, sepse ka shumë operatorë, shumë kompani në Kosovë, të cilat i ofrojnë.

Kemi heshtur kur e kemi parë edhe blerjen e uniformave edhe për atë bendin ceremonial që i kanë klasifikuar rreth 3 milionë e 500 mijë euro, edhe atëherë kemi heshtur. Pra, kemi heshtur edhe ku kanë blerë veshmbathjet rreth 3,5 milionë në mënyrë sekrete, e që në të kaluarën nuk ka ndodhur asnjëherë.

Kemi heshtur edhe kur e kemi parë atë që të më besoni, s'mund t'u besoja syve të mi që po e shoh, blerën e ekskavatorëve, buldozerëve, autokranit, pirunjerit në vlerë prej 3 milionë euro në procedurë sekrete. Po, s'janë këto mjete luftarake. Këtu i ke dhjetëra kompani të cilat i shesin në Kosovë.

Për të gjitha këto që i përmenda kemi pasur vërejtje, mirëpo fakti që kanë ardhur nga ushtria e Kosovës nuk i kemi diskutuar dhe nuk i kemi nxjerrë për diskutim publik, kemi heshtur.

Sot, kur e sheh të dezertuar nga detyra e tij ministrin e Mbrojtjes, vërtet s'mund të heshtësh. Ministër, zoti Ejup Maqedonci kudo që je, sot ke dezertuar përballë detyrës tënde më fisnike. Sot, të mos jesh në gjendje që të vish në Kuvendin e Kosovës dhe ta mbrosh punën tënde, angazhimin tënd, është e patolerueshme.

Sot, ajo që më së paku do të duhej ta bësh, është të japësh dorëheqje dhe ta lirosht atë detyrë.

Zoti ministër, je ministër që do të mbahesh mend që e ke lënë ushtrinë e Kosovës pa bukë. Nuk e besoj që të bën nder ty dhe as partisë suaj e as familjes tënde.

Të nderuar kolegë deputetë,

Kjo vërtet është një seancë që i kemi pasur dilemat tona a ta thërrasim apo të mos e thërrasim, sepse vërtet është e mjerueshme edhe është e turpshme. Por, kur e ke një ministër të tillë, i cili nuk brengoset aspak për një gjendje çfarë e ka sjellë ushtrinë e vet dhe një Qeveri të tillë dhe një mazhorancë, normalisht që nuk mund të rrimë duarkryq karshi kësaj situatë.

Kur e ke një Qeveri e cila e klasifikon fasulen si sekret shtetëror, që s'ka ndodhur asnjëherë në vendin tonë, si të heshtet përballë kësaj situatë.

Në njërën anë, e patë, kryeministri i Kosovës na alarmon që Serbia po ofrohet, ushtria serbe po ofrohet në 50 metra afër kufirit, qysh e thanë shumë parafolës para meje, dhe, në anën tjetër, ata të cilët janë të thirrur me ligjin e Kosovës që ta mbrojnë integritetin territorial dhe sovranitetin e Kosovës, pra ushtria e Kosovës, po të njëjtën ditë raporton komandanti i tyre që mbesin pa bukë.

Pra, nëse jemi vërtetë kaq në rrezik, qysh bre po e lini ushtrinë pa bukë?! Qysh mund të ndodhë kjo? Është e kuptueshme mospjesëmarrja e kësaj mazhorance në këtë seancë, sepse vërtet është për marre.

Ky Kuvend nuk e meriton ta vazhdojë punën e tij as edhe një ditë, qysh s'e meriton kjo Qeveri. Sa më shumë që vazhdojmë të punojmë aq më shumë do të ballafaqohemi me telashe dhe probleme të tilla. Dhe, nëse sa më shpejt që arrijmë ta çojmë vendin në zgjedhje, t'ia ndalim punën kësaj Qeverie, besoj që i ndalim edhe dëmet të cilat janë duke iu bërë në vazhdimësi vendit tonë.

Mendoj që si opozitë nuk duhet të ndalemi me kaq. Një ministri të papërgjegjshëm të Mbrojtjes, sikur ky që e kemi tani, i cili nuk rri në krye të detyrës së tij dhe largohet nga përgjegjësia e tij dhe nuk vjen në Parlamentin e Kosovës, në këtë Parlament i cili e ka votuar e ka zgjedhur që të raportojë për këtë situatë, nuk e meriton të vazhdojë.

Ne po i tregojmë edhe atij edhe kryeministrit edhe kësaj mazhorance që nuk do të ndalemi karshi këtij degradimi të madh që i bëhet ushtrisë së Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Zoti Driton Selmanaj e ka fjalën.

DRITON SELMANAJ: Faleminderit, i nderuar nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur ushtarë të ushtrisë së Kosovës,

Ne sot jemi mbledhur që të diskutojmë për furnizimin me ushqim për ushtrinë e Kosovës, jo sepse po përballemi me ndonjë mungesë globale të ushqimit, jo sepse kemi ndonjë embargo në ushqim, jo sepse kemi ndonjë pandemi në shkallë botërore të thatësisë, të them, ku s'ka ushqim bota dhe ne tash jemi detyruar të sillemi kështu, por për një arsye krejtësisht tjetër.

Dhe, cila është arsyeja? Arsyeja është që Albin Kurti i ka dërguar disa njerëz në Ministrinë e Mbrojtjes dhe jo vetëm në Ministrinë e Mbrojtjes, disa abuzues që të abuzojnë me paranë publike edhe në kafshatën e gojës së ushtarëve tanë.

Por, fatmirësisht kjo përpjekje për të abuzuar ose për të vjedhur edhe në kafshatën e gojës u bë publik dhe s'mundën ta realizojnë qëllimin. Domethënë, buka e gojës së ushtarëve tanë u mbeti në fyt hajnave të kësaj Qeverie, faktikisht. Dhe, ky është realiteti.

Kur po analizoj, po provoj të vij te një konkluzion, kjo po më del. Krejt kjo është bërë për shkak që është dashur të ketë kontratë sekrete dhe përmes kontratës sekrete tashmë është sekret publik që po vidhet masivisht. Por, fati i mirë që u ndal kjo.

Unë nuk po arrij ta kuptoj abstenimin e shumicës parlamentare dhe të Qeverisë. Pse nuk vijnë këta dhe të ballafaqohen me këtë dhe të na i ofrojnë argumentet e tyre dhe ndoshta more e bindin popullin që e kanë mirë dhe ne e kemi keq.

Unë nuk do të mund të besoj që deri këtu shkon, të bëhet njeriu, ose 60 deputetë të sillen kështu për faqe të zezë. Pse? Se duhet të mbrohen disa abuzues pse janë të partisë sime. Unë ju bëj thirrje kolegëve deputetët të pushtetit, dilni së paku shpërlani fytyrën tuaj, sepse fytyra e Albin Kurti, e Shemsi Sylës, e Dugollit, e Maqedoncit nuk e shpërlan dot as Adriatiku.

Dilni së paku për vete, kërkoni para njerëzve. Po dilni dhe thoni tekefundit, na falni bre se s'e kemi ditur që jemi bash kësi lloj abuzuesish. Për që ka dalë Kuvendi jashtë funksioni, më ne e kemi kuptuar. Ka kohë. Shumica parlamentare ka vendosur që mandatin e vet kushtetues, të abstenoj prej mandatit të vet kushtetues.

Ky është vendi ku diskutohen gjërat. Ky është vendi ku ballafaqohen gjërat. Ky është vendi ku Qeveria ballafaqohet me përfaqësuesit e popullit, por këta kanë zgjedhur që të ikin. Dhe, nuk është çështje e tanishme. Është çështje e disa muajve.

Problemi është se si erdhëm ne deri në këtë stad. Pse kemi ardhur deri në këtë stad, kur ne tash diskutojmë a kemi apo nuk kemi bukë për ushtrinë tonë. Dhe, t'ju them të drejtën buka është vetëm njëra prej temave. Nuk është gjithçka që flet për ushtrinë. Ka kohë që unë i shoh rrugëve të Kosovës ushtarët tanë me autostop, duke pritur që të hip për t'i marrë dikush.

Unë ka kohë që po shoh dhe po bisedoj, ka ushtarë të FSK-së që pas orarit të punës punojnë si taksistë. Ka ushtarë të ushtrisë sonë që pas punës punojnë si kamerierë. Ky është problem serioz. A deri këtu kemi mbërri ne me dinjitetin e ushtarit tonë saqë ta detyrojmë atë të punojë edhe pas orarit dhe çka, ne të krekosemi e të themi se kemi ushtri profesionale.

Jo, jo, kjo nuk është ushtria profesionale, absolutisht. Kjo nuk është ushtria profesionale që ne kemi synuar. Dhe, nëse ne e shohim këtë ushtri tonë me mungesë ushqimi dhe me mungesë të të ardhurave të dinjitetshme.

Ndërkohë, e shohim edhe Njësinë Speciale duke protestuar para zyrave të Qeverisë. Po kujt i dërgojmë mesazh? Cili është mesazhi që i dërgojmë ne, ose kujt i pëlqejnë këto pamje ose këto lajme? Ose, edhe lajmet e tjera që Kosova është në ditën 475-të me sanksione. Që Kosova i ka prishur punët me aleatët ndërkombëtarë. Që Kosova tash as me bukë s'po mund ta ngopë ushtrinë.

Po, kënaqet me këto? Veç Serbia. Unë nuk e di nëse është dikush tjetër që thotë, more në rrugë të mirë jemi. Përfundimi është që vetëm Serbia duartroket.

Ne kemi abstenim krejtësisht edhe të presidentes. Thua ti këto gjëra janë duke ndodhur në ndonjë ishull, në një kontinent krejtësisht tjetër, jo brenda Kosovës. Ndërkohë, ne po flasim për institucionet vitale të shtetit. Kemi ikje të përgjegjësisë prej kryeministrit. Kemi ikje të përgjegjësisë prej presidentes. Kemi ikje të përgjegjësisë prej ministrit. Së paku ai sikur të vinte këtu edhe të na i thoshte nja dy fjalë. Edhe nëse do të fliste pa lidhje do ta dëgjonim me kujdes. Por, ikin krejt këta.

Unë e kam përshtypjen që edhe qysh kanë ikur edhe në kohë të tjera të rënda për Kosovën, këta edhe nesër ikin kështu dhe e lënë Kosovën në baltë. A ky është 51%-shi? Kjo është shpresa që thuhej që po vjen në Kosovë, për këtë vend.

Unë jam i sigurt, sepse kam pasur fatin të jem këtu edhe gjatë periudhës së luftës, UÇK-ja nuk ka pasur problem me ushqim për shkak të solidaritetit të madh të këtij populli. Kjo shoqëri e ka mbajtur gjallë me ushqim, e sot ne 25 vjet pas luftës, me shtet, me 4 miliardë euro buxhet, s'po kemi mundësi të gjejmë si t'i furnizojmë dinjitetshëm ushtarët tanë.

Jo, jo, kemi gabuar dikush si shoqëri. Kemi gabuar diku shumë. Kemi shkelur diku. Se të vijë situata, të vijë një klasë kaq e papërgjegjshme politike saqë ushtrinë e shtetit ta nëpërkëmbë kështu, po them shpeshherë nuk po arrij të gjej kurrfarë shpjegimi.

Unë po dua ta mbyll krejt në fund me një fjali fjalimin tim. Kështu, më tepër po ju drejtohem votuesve të Lëvizjes Vetëvendosje, po ju them kështu: një Qeveri që e vjedh magjen e shtetit, në

rezervat shtetërore, që e vjedh miellin, e vjedh kripën, e vjedh vajin dhe provon ta vjedh edhe në ushqimin e ushtarëve të vetë, për besë vetëm në shërbim të shqiptarëve nuk është. Në shërbim të tjetërkujt mund të jetë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Selmanaj! Zoti Bekë Berisha e ka fjalën. Besnik Tahiri e ka fjalën.

BESNINK TAHIRI: Faleminderit, i nderuar kryesues, nënkryetar i Kuvendit, profesor Hoxhaj! Të nderuar deputetë që jeni prezentë, Qytetarë të Republikës së Kosovës, E thanë prej kolegëve deputetë me vështirësi të mëdha dhe thënë të drejtën, të jem shumë i singertë, jo me mburrje po e trajtojmë një temë, që nuk do të duhej së paku të jetë temë për një Kuvend të Kosovës edhe për një shtet e për një kom, i cili mburrjen më të madh e ka Ushtrinë e Çlirimtare të Kosovës, e cila është burim i forcës së Kosovës, i ushtrisë së Kosovës.

Para se t'i them disa elemente që mendoj janë të rëndësishme që të thuhën në këtë seancë, nuk mundem pa e thënë se secilin ushtar që e shohim në uniformë, e shohim në kazermë, e shohim në rrugë, e përqafojmë në familje na e jep ndjeshmërinë, krenarinë, dashurinë e që besa edhe sigurinë e vendit, e të fëmijëve e gjeneratave që vijnë.

Pra, në qoftë e ka një krenari dhe në qoftë se ka një ndjenjë që na bën të ndjehemi mirë, është mu ushtria e Kosovës, e cila është në funksion e në shërbim të të gjitha virtyteve që një shtet që nuk ka ekzistuar e sot ekziston i ka.

Janë ushtarët, u tha edhe më herët, të cilët janë aty për t'u vetëflijuar. Janë aty për t'u sakrifikuar. Janë aty që t'i qëndrojnë besnikë flamurit tonë, ndjenjës sonë deri në frymën e fundit, e të na vije puna sot për këta djem e vajza që janë krenaria jonë të flasim e të bisedojmë e të debatojmë për ushqimin e tyre, kjo nuk ka emër as mbiemër tjetër përveç: marre, marre, marre!

Por, në këtë Qeveri ndjenja e përgjegjësisë, edhe ndjenja e turpfit, edhe ndjenja e skuqjes nuk ekzistojnë. Për shkak se ky mosplanifikim, në fakt është planifikim shumë i mirë për ta. Është planifikim shkurt edhe shqip, me bazë serioze të korrupsionit. Se, duke e ditur, duke e pasur përpara në tavolinë në portofolio kontratën e furnizimit me ushqim, duke ditur kur nis e kur përfundon, duke e ditur cila është procedura e kontraktimit, e menaxhimit, e shpalljes, e vendimit dhe të shtyhet deri në ditën e fundit, duke luajtur ping-pong, jo e ka nënshkruar zëvendësministri, e jo duhet nënshkruar ministri, e jo duhet kryeministri, kjo nuk flet asgjë tjetër përveçse për elementin e një qeverie që trendin e menaxhimit publik e ka fshehtësinë. Pra, duan gjithçka të bëjnë fshehtë për synimet e tyre të ngushta korruptive.

Po shkoj edhe një hap më tutje, na kujtohet të gjithëve, e më kujtohet edhe mua për shkak se kam qenë në Qeverinë Haradinaj kur është diskutuar themelimi i ushtrisë së Kosovës. Po e them në foltore të Kuvendit nën betim, vendim më të vështirë në atë qeveri nuk ka pasur se sa vendimi për themelimin e Ushtrisë së Kosovës dhe miratimin e ligjeve të ushtrisë në këtë Kuvend. Ka pasur shumë zëra skeptikë, ka pasur deklarata publike, ka pasur kërkesa për ta shtyrë.

Por, atëherë kemi menduar që një vendim i tillë është i duhur dhe në kohën e duhur. Kjo, u vërtetua sot. Ushtria e Kosovës duke qenë krenaria jonë, këto katër vjet u ballafaqua me sfida të mëdha. Shumë prej tyre nuk po mund t'i flasim. Nuk po mund të tregojmë për kushtet që i kanë, për gjendjen e uniformës, për presionin politik, për ndikim anësor, për mungesën e kushteve themelore, e mbi të gjitha për mostrajtimin me dinjitet që u bëhet njerëzve që ne i kemi krenari e që e bartin uniformën e Ushtrisë së Kosovës.

U detyruam të flasim, e fatkeqësisht në këtë detyrim nuk ka ballafaqim. Në mungesë të ballafaqimit, ne po e marrim mundin dhe po ndalemi s'po i themi të gjitha me të vetmin qëllim, t'i flitet popullit të Kosovës, e t'i thuhet: "O popull, ne e dimë pse e kanë marrë këtë besim 50%, për shkak se ju, në një masë e madhe u patën irrituar me "regjimin e vjetër". Ai nuk ka qenë regjim, por regjim është ky.

Dhe, ia dhatë besimin një kaste politike, një kabinet qeverisës që nuk ka guxim të marrë asnjë vendim. Pse more nuk iu vjen turp të shëtiteni poshtë e përpjetë, herë në një shtet e herë në tjetrin, e të mos flasë kryeministri i vendit një fjalë të vetme për këtë problem, por të ikë e të fshihet. Ballafaqimin me qytetarë e ai e ka vetëm kur i duhet vota. Po të kishte përgjegjësi institucionale, një kabinet qeveritar do të uleshin e t'i jepnin përgjigje një teme, që me vështirësi po e debatojmë.

Ne si deputetë të zgjedhur të popullit nuk kemi derë e as platformë tjetër, përveçse një institucioni që buron prej popullit të Kosovës - Kuvendit të Kosovës. Këtu duhet t'i debatojmë dhe prej këtu t'i plasojmë porositë te qytetarët e Kosovës. Unë jam i bindur që kjo situatë nuk do të shkojë kështu, shpejt vjen 28 nëntori, që është 27-vjetori i daljes publike të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, do të mbushen sheshet me veteranë, se nuk do të mund më të durojnë. Nuk ka gjë më të vështirë se për një familje, e cila e ka varrin e dëshmorit afër, e një veteran që mezi e lidh muajin me muaj, e me një të burgosur politik që është kalbur në burgje të Serbisë, e ta dëgjojë Kuvendin e Kosovës gjashtë vjet pasi u themelua ushtria të flasë ka ushqim apo jo.

Qepa u bë sekret shtetëror, biberi i zi u bë sekret shtetëror, e kripa e trangujt. Po si nuk iu vjen marre të flasin kështu. Mbi çfarë logjike e trajtoni këtë temë me këtë papërgjegjësi të madhe? Turpi do t'iu mbulojë dhe me këtë turp nuk do të mund të vini në asnjë seancë të ballafaqoheni, për shkak se gjithçka që po ndodh po bëhet me plan. Dhe, plani dihet, është korrupsioni, fshehtësia dhe sabotimi i institucioneve të sigurisë.

KRYESUESI: Tash fjalën e ka deputeti Ferat Shala.

FERAT SHALA: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuara media,

Qytetarë të nderuar,

Tani secili nga ne këtë dukuri, këtë fenomen apo këtë aferë e sheh nga prizmi i këndit të tij dhe argumenteve që ofron. Ajo çka është e pashme, e prekshme, e matshme, sipas këndit, themi janë dy dukuri.

Dukuria e parë që është qind për qind aferë korruptive në përmasa deri në sabotim. Pra, deri në shkallën e sabotimit dhe për këtë jo vetëm shteti ynë, po të gjitha legjislaturat demokratike kanë përgjigje, kanë legjislacion, kanë institucione që duhet dhe shpresoj e besoj që duhet ta trajtojnë, por ky fenomen nuk ka rrugë tjetër, zgjidhje tjetër përveç atij ligjores. Pra, çështja e korrupsionit ka vetëm një përgjigje, ligjin dhe rregullat që tashmë janë të njohura. Fenomeni i dytë, dukuria e dytë është kryeministri, është Albin Kurti, kreu i qeverisë së shtetit, i cili hesht, i cili ik, i cili nuk ka përgjegjësi as morale, as etike, as llogaridhënie, as transparencë dhe fatkeqësisht i ik edhe aspektit ligjor dhe komunikimit parlamentar. E ka defunksionalizuar jetën parlamentare si rezultat i ikjes dhe manovrimeve politike tash e gjashtë muaj, pa asnjë seancë të mirëfilltë ku jemi bashkë dhe debatojmë për dukuritë.

Nuk do të vija në këtë konstatim sikur të mos ishim bashkërisht këtu, po flas për dukurinë e kryeministrit, sikur të mos e kishim këtë situatë që ju sot debatuar shumica, pa u ndalur shumë te kjo, që për mua është jashtëzakonisht e ndjeshme dhe prekë si me thënë strukturën më të mirëfilltë të sigurisë së shtetit, por dukuri të tilla kemi parë edhe para pak ditësh, kryeministri heshti, iku, nuk dha llogari edhe për aferën tjetër të madhe të korrupsionit që tashmë pjesa e parë e drejtësisë ka vepruar, çështjen e ambalazhuesve të ujit.

Pra, dhjetëra milionë euro, kryeministri prapë ik, dhjetëra milionë euro korrupsion i pastër, i argumentuar nga drejtësia dhe mediat tashmë publikisht, kryeministri nuk ka koment, kryeministri largohet dhe improvizon, kryeministri është bashkëpërgjegjës, sepse ka dokumente të shkruara dhe zyrtarisht që ka qenë së paku gjashtë muaj më parë i informuar për afera të tilla, sikur që besoj fuqishëm që ka qenë i informuar edhe për aferat korruptive në Ministrinë e Mbrojtjes, në aferat puro korruptive deri në sabotim në Ministrinë e Mbrojtjes.

Kryeministri ik edhe te aferat e tjera, nuk ka llogaridhënie as për rezervën shtetërore, edhe pse kryeministri ka qenë i informuar edhe këtu, edhe me imela nga vartësit e tij që rezerva shtetërore nga 2022 2023, 2024 nuk kanë ardhur në Kosovë. Kryeministri si njeriu i parë institucional i shtetit s'ka koment, s'ka përgjigje, s'ka llogaridhënie, s'ka veprim të masave, nuk ka veprim të

masave ndaj vartësve të tij tej mase të korruptuar. Dhe, sot kryeministri hesht përsëri, as juridikisht nuk përgjigjet, as në kuptimin etik e moral nuk ka përgjigje.

Kryeministri hesht edhe para aferave të tjera, të energjisë, të mafisë energjetike, ku përreth tij dhe Kabinetit të tij realisht gravitojnë strukturat, të cilat tashmë Kosovës vetëm për katër vjet qeverisje ia kanë marrë mbi 560 milionë euro, investimet dhe subvencione e të cilat edhe sot Kosova është vendi i vetëm në rajon që dominojmë me importe të energjisë. Pra, ku është fenomeni kryeministër në këtë relacion? Unë nuk i shoh, tha të vegjlit, sepse janë grupe të interesit brenda një strukture, të cilën e koordinon, po kush mund të më besojë ose kush mund të besojë sot që ndodhin të gjitha këto afere korruptive brenda shtetit, dikastereve dhe kryeministri nuk e di. Kush guxon sot të marrë veprime të tilla juridike, financiare, ekzekutive dhe kryeministri të mos e dijë. Ne e dimë jetën parlamentare, institucionale, e njohim mazhorancën që është, si funksionon dhe si ka ardhur deri në pushtet.

Këto të gjitha i di kryeministri, 100% jam i bindur, është i informuar përveç strukturave të brendshme të vetat, e ka edhe shtetin në dorë, edhe mekanizmat legalë që ia ka dhënë vendi dhe Kushtetuta jonë dhe përsëri s'kemi llogaridhënie, dhe përsëri kemi degradim të skajshëm institucional deri tek tash te ushtria që kemi ardhur.

Pra, për mua fenomeni është kryeministri, edhe juridikisht i papërgjegjshëm, edhe në kuptimin etik dhe moral jollogaridhënës para institucioneve që Kushtetuta ia jep obligim të vijë këtu e të ballafaqohet dhe ta zbërthejë të vërtetën korruptive katërvjeçare të kësaj qeverie. Fenomeni i fundit është ky që e shohim sot, që është më shumë se sa korrupsion, por kryeministri prapë ik dhe nuk e di deri kur di të ikë. Jam thellë i bindur që në një moment të caktuar askush s'mund t'i ikë as drejtësisë, dhe as aspektit moral e njerëzor.

Faleminderit!

KRYESUESI: Ariana Musliu-Shoshi dhe le të përgatitet Ardian Kastrati.

ARIANA MUSLIU-SHOSHI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të dashur kolegë deputetë dhe qytetarë,

I shihni Albinin dhe cubat e tij që sot mungojnë këtu, sigurisht janë të zënë duke bërë plane se si të vazhdojnë të vjedhin. E, për deputetët e mazhorancës nuk po flas hiç, këta deputetë të mazhorancës nuk kanë guxim as të kalojnë nga Kuvendi, lëre më të vijnë këtu dhe të kërkojnë llogari, siç do të duhej të kërkojnë llogari nga ministrat, të cilët i kanë zgjedhur vetë.

Sidoqoftë të kthehemi në temë, të gjithë jemi më se të vetëdijshëm që tema për të cilën po diskutojmë sot prek bërthamën e sigurisë dhe të sovranitetit të vendit tonë. E dimë që edhe siguria dhe sovraniteti i vendit qëndrojnë mbi çdo parti, mbi çdo individ dhe mbi çdo temë tjetër. Gjendja e cila është krijuar në Forcën e Sigurisë është e papranueshme dhe tregon që dështimi i

qeverisë për të përmbushur një nga detyrimet bazike ndaj FSK-së që është shtylla kryesore e mbrojtjes sonë kombëtare dhe simbol i përkushtimit të Kosovës për paqe, stabilitet dhe siguri në rajon. Dhe, sot në vend që të flasim për përparimin dhe përafrimin me forcat moderne ushtarake, ne po flasim për një aspekt jetik të mirëqenies së ushtarëve tanë, pra për bukën e tyre.

Për këtë arsye është obligim dhe detyrë e jona primare që të reagojmë me ngulm dhe të kërkojmë përgjegjësi dhe mbi të gjitha, llogari nga qeveria aktuale, e cila ka sjellë situatën në këtë pikë denigruese dhe jashtëzakonisht të rrezikshme. Jo vetëm ne si deputetë të këtij Kuvendi, por secili qytetar sot me shumë të drejtë mund edhe të shtrojë pyetje: si është e mundur që FSK-ja të përballet me mungesa bazike? Pa armë, pa rroga, pa paga të arsyeshme, pa bukë dhe pa dinjitet!

A është normale që 25 vjet pas luftës ushtarin tonë ta detyrojmë të mbahet në këmbë vetëm nga krenaria? A është normale që të heshtim kur Albin Kurti përmes një kontrate njëburimore ka siguruar ushqim për qentë, paramendojeni, kolegë të nderuar, ushqim për qentë të ushtrisë dhe policisë, por jo për ushtarët.

Unë dhe të gjithë ju e di që pajtoheni që nuk është normale. Nuk është normale, sepse sot ushtari i Kosovës ballafaqohet me mungesa bazike, siç është: e para, kjo që sot po e diskutojmë, ushqimi cilësor. Dhe çështja e të ushqyerit nuk është vetëm që ta shuajë urinë ushtari ynë, por është thelbësore për shëndetin, moralin, motivimin dhe gatishmërinë e ushtarëve tanë që duhet të përballen me situata, të cilat u vijnë çdo ditë.

Ushtarët tanë sot kanë ushqim pa proteina dhe kalori, sipas ushqimit që është me standarde të ushtarëve në rajon dhe më gjerë. Mirëpo, për ushtarët tanë ushqimi përgatitet me çka do që ka qëlluar në rezervë, kjo është në kundërshtim e thashë me standardet e ushtrisë. Dhe, çfarë është më e keqja, u tha nga kolegët deputetë, shujtën ditore ushtarit tonë ia përgatit personi që nuk ka certifikatë të sigurisë, pra mund edhe të helmohet qëllimisht dhe askush të mos marrë përgjegjësi për këtë. E dyta, kemi marrë të gjithë ne si deputetë shumë raporte për keqpërdorime edhe me fondet e ushtrisë, e që si rezultat kanë mungesa të vazhdueshme të veshjeve dhe pajisjeve që janë thelbësore për të siguruar që ushtarët janë të jenë të përgatitur dhe të pajisur për përmbushjen e detyrave të tyre.

Sot, ushtari i Kosovës ka uniformë e çizme të grisura, sepse kjo qeveri është dëshmi që vjedh edhe me tenderë të ushtrisë. E treta, sot ushtarit të Kosovës nuk i paguhen orët shtesë të shërbimit dhe është e vetmja kategori që është e përjashtuar me ligj nga Albin Kurti dhe kjo po shihet që është me koordinim. E katërta, ushtarët tonë nuk kanë sigurim shëndetësor. Sot, ushtari i Kosovës nëse lëndohet në detyrë, kjo qeveri le që nuk i ofron kujdes, por e përjashton edhe nga puna, kemi raste konkrete. Dhe, përveç keqtrajtimit deri në mjerim të ushtrisë tonë, nën këtë qeverisje është evidente edhe tendenca për të politizuar të gjitha institucionet e sigurisë, përfshirë edhe FSK-në. Dhe një tendencë e tillë duhet të ndalet menjëherë dhe me ngulm.

Është jashtëzakonisht e dëmshme, kolegë deputetë, që kjo forcë të përdoret si mjet propagande e për fitime politike. Në fakt, FSK-ja ka nevojë për investime serioze në infrastrukturë, në teknologji, në trajnim të avancuar dhe të përmbushë standarde që janë kompatible me ato të NATO-s dhe të jetë e gatshme që të mbrojë integritetin territorial të Kosovës dhe qytetarët e saj, si dhe të angazhohet për paqe dhe stabilitet në rajon dhe jo vetëm. Nuk ka nevojë për retorika dhe premtime boshe elektorale, por për një rritje të kapaciteteve dhe transformim në një forcë të mirëfilltë ushtarake ashtu siç e meriton. Kjo qeveri duhet të japë llogari në mënyrën se si po i shpenzon fondet për FSK-në dhe duhet të japë llogari për të gjitha vendimet strategjike që e prekin këtë Forcë.

Është evidente që mungon transparencja dhe llogaridhënia dhe si rezultat mungon edhe fuqizimi dhe afrimi me standardet ndërkombëtare. Meqenëse situata është manovruar në një pikë denigruese për ushtarët dhe për Kosovën, ministri Maqedonci dhe Albin Kurti, të dy duhet të japin llogari për situatën e krijuar, sepse përgjegjës kryesor dhe e vetme për çdo mangësi të kësaj natyre është Qeveria.

Siguria kombëtare nuk guxon të bëhet pjesë e kompromiseve dhe kalkulimeve politike. Forca e Sigurisë së Kosovës nuk duhet të mbahet me lëmoshë, por të trajtohet me respekt dhe me dinjitet siç është trajtuar nga qeveritë e tjera. Nuk mund të pranojmë që ushtarët tanë të përdhosen deri në këtë nivel, Forca e Sigurisë së Kosovës nuk është vetëm një forcë mbrojtëse, por është simbol i shtetit, mburojë për qytetarët tanë dhe rezultat i përpjekjeve shekullore për liri, siguri, pavarësi dhe identitet.

Të nderuar qytetarë të vendit tonë, shtrohet vetëm një pyetje shumë të thjeshtë: si është e mundur që në vitin 2024, kur Serbia ushtrisë së vet i blen avionë luftarakë nga Franca, Kosova të mos ketë bukë, uniforma e çizme për ushtarët e saj, madje si rezultat i politikave të Albinit, të jetë e ndëshkuar dhe e përjashtuar nga pjesëmarrja në programin prestigjioz “Defender Europe 2023”.

Prandaj, qytetarë të dashur, mendojeni mirë kur po ia besoni të ardhmen e këtij vendi, sepse përkrahja e gabuar ju bën bashkëfajtorë në shkatërrim. Krejt në fund, deputetë të dashur kam vetëm një lutje për të gjithë vajzat dhe djemtë tanë që të mos dorëzohen e të demotivohen nga udhëheqës politikë që në Kosovë janë veç kalimtarë, që të ardhmen e fëmijëve e shohin në Norvegji, e që në tokën e Kosovës nuk kanë as varr e as pronë. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Ardian Kastrati, dhe le të përgatitet Hajdar Beqa.

ARDIAN KASTRATI: Të nderuar qytetarë,
I nderuar nënkryetar, profesor Hoxhaj.
Dhe ju deputetë!

Sa më bosh stomaku i ushtarëve, aq më plot xhepi i zuzarëve. Ne duhet thjeshtësuar situatën, prokuroria duhet aktivizuar sa më shpejt, sepse ky është super skandal i hajnave të fasules dhe të çorbave. Duhet arrestuar këta Pablo Eskobarat e Kosovës, sepse profili i tyre i kriminalizuar është i Pablo Eskobarit, dallimi e dini ku është, që Pablo tregtonte me drogë e këta tregtojnë me ushqim të ushtarëve të FSK-së. Dallimi është që Pablo Eskobari ka plaçkitur me armë e me maska, këta plaçkitin me stilolaps e me firma dhe kështu me finesë e bëjnë art korrupsionin dhe urinë e ushtarëve tonë e bëjnë monedhë të përfitimit të tyre personal.

Pra, këta vjedhin pasul, konserva që i thoshin përpara populli “narezak”, për të ngrënë vetë salmon, kallamari edhe karkaleca, paramendo çfarë kapërcimi me narezakut në salmon e karkaleca është. Këtë konservën narezakun ndërsa ua ka lënë ushtarëve të shkretë të FSK-së. Pra, kjo është qeveria e hajnave të pasulit që gëzohet me tenderët duke i përtypur kokrrat e pasulit një nga një. Këta hajna të pasulit e të gullashit paramendo e kanë shpallur top sekret pasulin, çfarë turpi i botës dhe kjo është simptoma më e thellë e korrupsionit institucional në historinë e re politike institucionale të këtij vendi që e rëndon, në fakt, thelbin e këtij shteti sepse bëhet qare për Ushtrinë e Kosovës.

Dhe, kjo në asnjë mënyrë nuk është dështim operacional, por është një plagë morale që e përshkruan raportin e këtij kryehajnit me interesin kombëtar, sepse a ka interes kombëtar më të madh se sa Ushtria e Kosovës. Këta hajna e kanë rrezikuar moralin dhe operativitetin e FSK-së në një kohë kur stabiliteti dhe gatishmëria është më se e nevojshme përballë sfidave të sigurisë në rajon. Ajo FSK për të cilën folën kolegët këtu dikur ishte një simbol i forcës dhe i stabilitetit, me hajninë e hajnave të pasulit e të gullashëve ka shpërthyer në një emblemë të korrupsionit. Emblemë të korrupsionit duke na lënë kështu përmbraja një peizazh goxha të zbrazët moral. Ushtria, siç e dimë ne të gjithë, duhet të jetë një bastion i shpresës dhe i krenarisë, e tani duket si një anije e fundosur pas skandalit të fasules në të cilën ata e çojnë dorën në këtë oqeanin e errët të banditëve dhe skandalet e kësaj qeverie duke kërkuar ndihmë. Mozomakeq prej kujt kërkojmë ndihmë. Morali i ushtarëve tani është i kërcënuar duke i lënë ata me u përballë me pyetje ekzistenciale: a do të kemi nesër ushqim në punë apo duhet me marrë ne me veti?

Raste të tilla të mungesës së ushqimeve apo të kushteve elementare të ushtrive historia i ka harruar moti, ka mundur të ketë dikur kah Lufta e Parë Botërore më 1917, kur për shembull, italianët kur e kanë humbur atë Betejën e Kaporitos, janë çuar në protesta ushtarët, e me ta edhe qytetarët kanë protestuar kundër Qeverisë. Në 1918 ushtarët gjermanë në fakt e kanë bërë të njëjtën lëvizje, duke dalë kundër monarkisë që pastaj shkoi në republikë. Po e kemi një rast më 1917, në tetor, atë revolucionin bolshevik që po të kishte qenë Albini në opozitë, e kishte bërë. Mezi s’do të priste ta kishte këtë situatë, sepse i kishte keqpërdorur ushtarët për të filluar protesta, ashtu siç bënë ushtarët rusë atëkohë duke iu bashkëngjitur atij revolucionin bolshevik.

Kjo që ka ndodhur me pasul e gullash, është masakër ndaj moralit të ushtarëve të FSK-së. Është masakër. Hajnat e pasulit e kanë zbuluar më duket një sekret, që ushtria e uritur nuk bën zhurmë, kështu që veç grahni e vidhni se nuk është kurrfarë problemi. Kjo hajni brutale e sfidon idealin e ushtarit, e sfidon idealin e rezistencës dhe përgatitjes së tyre të përhershme. Këta hajna kanë rrezikuar moralin dhe operativitetin e FSK-së, e thashë dhe po e përsëris edhe një herë.

Krejt në fund, këta hajna të pasulit e të çorbave jo vetëm që shkelin ligjin, se kjo po shihet, Prokuroria ka këtu punë, por e kanë shkelur keq dhe shumë poshtërsisht edhe nderin dhe uniformën e çdo ushtari të FSK-së.

Mbrëmë më thirri një kushëri i imi punon në Shtutgard me “hillt”, kështu, tha ishim në takim në diasporë me Albinin, e kemi kallë krejt, edhe i thamë “hiç mos ta nin kryeministër për pasul që po të akuzojnë e po na thonë që i ke vjedhur, se ne vijmë në luftë me pasul tonin, me çorba tonat, nuk kemi kurrfarë problemi”.

A e di çka është kjo e rrezikshme? Kjo është çka do Albini. Pra, t’i ushqejmë idealet dhe jo ushtarët. Mbi këtë slogan, paramendo, Zot ruana, të bëhet një luftë nesër, slogani i tij do të ishte: “Të uritur për atdheun”.

Prokuroria duhet sa më shpejt të aktivizohet. Ky është super-skandal. Ky është poshtërim i FSK-së. Sa më shpejt të aktivizohet për hajnat e pasulit dhe të çorbës. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Beqaj, fjala është për ju.

HAJDAR BEQA: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Sot, pa dëshirën tonë na është imponuar në një seancë të jashtëzakonshme të diskutojmë për një çështje që me të vërtetë është e jashtëzakonshme, për furnizimin me ushqim të ushtarëve të Republikës së Kosovës.

Fillimisht, kur e kam parë si lajm në media që ka problem furnizimi i ushtrisë me bukë, kam menduar që është një lajm i rrejshëm, se nuk më ka funksionuar në atë moment logjika që pas 12 qershorit të vitit 1999 të diskutojmë për furnizim me ushqim për ushtrinë tonë.

Në vend që të diskutojmë tani sesi të hyjë ushtria jonë në NATO, si të anëtarësohemi, si të furnizohemi me armatim, me pajisje teknologjike, si të avancojmë ushtrinë e cila është shumë e përgatitur, jemi mburrur me ata djem e vajza që janë sot në ushtri, e sot duhet të shikojmë një zgjidhje dhe të diskutojmë si t’i furnizojmë me bukë.

Ushtria jonë po degradohet, në vend se të avancohet. Në vend se sot të diskutojmë për planin dhjetëvjeçar, si po përmbushet, a po përmbushet, a duhet ta rishikojmë atë plan, po me kë ta diskutojmë? Me një ministër, i cili nuk vjen sot të flasë për këtë çështje, një ministër që në vend se sot të ishte në vendin e punës, ku e marrë mandatin dhe të japë llogari pse ka ardhur në këtë situatë degradimi, ai shkon dhe bën filma në mensë te ushtria kinse po ushqehet me ushtarë.

Një ministër i cili sot thotë, apo thonë mediat, që i ka shkruar letër Kryeministrit që unë nuk do ta nënshkruajë tenderin e ushqimit, sepse zëvendësministri ka dorë aty. Tash, nuk e dimë a ka dorë ministri a zv.ministri, po e dimë që aty ka mungesë të ushqimit. Është keq për neve, 25 vjet liri të mos ketë ushqim për ushtri. D.m.th. nuk e kuptoj këtë.

Zv. ministri ka thënë që është kontratë konfidenciale, d.m.th. është sekret shtetëror furnizimi. Në rregull, po ia lëmë sekret shtetëror, po çojeni ushqimin. Edhe sekret shtetëror, edhe jofurnizim, kjo me të vërtetë nuk ka vend tjetër veçse... Këta në vend se të vijnë sot në Parlament, apo të shkojnë të hanë bukë atje, është mirë vullnetarisht ministri ta kapë përdore zv.ministrin dhe të shkojë para se të japë dorëheqje, një herë të shkojë te Kryeprokurori të tregojë çka kanë bërë me këtë tender, sepse po i vjen era kësaj pune. Po shihet, ka marrë ajër kjo punë dhe po shohim plot deputetë të kësaj mazhorance, sot u deklaruan do ta bojkotojmë seancën.

Ne i kuptojmë, se disa i kanë familjarët, e kanë vëllain sekretar, disa kanë interesa ndoshta te kompanitë përkatëse që janë në luftë kush ta marrë tenderin, disa të tjerë mendojnë po mendojnë që po i hyjmë në hatër atij Kryeministrit, i cili nuk po bën asgjë për këtë vend. Por, unë jam shumë optimist që këta po i bojkotojnë përgjegjësitë e tyre, që po i bojkotojnë qytetarin, Ushtrinë, Policinë, mësimdhënësit, zjarrfikësit dhe të gjitha shtresat dhe popullin në përgjithësi, do t'i bojkotojë edhe qytetari. Do t'i bojkotojë atëherë kur është koha, që do të vijë shumë shpejt edhe ajo ditë shkurti po ofrohet.

Nuk di a i vjen keq këtij kryeministri e këtij ministri e atij zv.ministri të shkojë të bëjë homazhe para dëshmorëve, para heronjve, kur ushtrinë e Kosovës që është trashëgimtare e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, është trashëgimtare e Adem Jasharit, të lihet pa bukë. Nuk di qysh kanë fytyrë të shkojnë me lule aty. Qysh kanë fytyrë para familjarëve të dëshmorëve, të heronjve, të martirëve, të zhdukurve? Nuk di qysh kanë fytyrë t'i dëgjojnë edhe shtetet fqinje, kur kryeministri bën filma deklarativë që ushtria serbe po na afrohet, në të njëjtën kohë e krijon një imazh të keq për ushtrinë e vendit të vet, nuk i lë d.m.th. në një furnizim të tillë të ulët të ushqimit. D.m.th. s'ka furnizim me bukë. Nuk e kuptoj këtë situatë kujt po i shërben ky kryeministër. Pse po e qet ushtrinë tonë? Në vend se të krenohemi me të, ne krenohemi me ushtrinë, i ka lënë pa këpuca, pa çizme, pa gardërobë, për shkak të tenderëve, apo e di ai cilat janë ato arsye. E sot, i lë edhe pa bukë.

Është keq edhe ata të cilët sot që e mbrojnë lirinë e Kosovës, e paguajnë çmimin që janë në burg, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi, Rexhep Selimi dhe të tjerët t'i dëgjojnë këto lajme nga Haga, që njëzetepesë vjet pas lufte ne nuk po kemi bukë ta ngijmë ushtrinë tonë. Ne kemi bukë, kemi mjete të mjaftueshme, Qeveria po mburret, po thotë, ne kemi ruajtur shumë mjete në banka. Po nuk po i kryen detyra. Nuk po i kryen detyrat që i ka.

Unë bëj thirrje si deputet, duke i përgëzuar në këtë rast edhe iniciuesit e këtij debati, bëj thirrje që urgjentisht të hiqet kjo temë nga diskutimi. Të furnizohet ushtria. Të gjejnë rrugë ligjore ta furnizojnë ushtrinë me bukë, me ushqim cilësor, me vlera kualitative, ashtu siç e kanë edhe me rregullore. Sepse, aty ka një rregull, kanë rregullore, ka ligj që duhet të përmbushet.

Nuk e di, Qeveria dështoi, edhe Kryeministri edhe varësit e tij, që mendoj dorëheqja është shumë pak. Po ku mbeti ajo Presidentja e vendit që me Kushtetutë është komandante supreme? As tash nuk duhet të kyçet? Me të vërtetë është keq dhe nuk di çka t'i them kësaj më shumë.

Ne këtu po e shohim që ka shkelje ligjore, ka vend për Prokurori, por në të njëjtën kohë ka ikje prej përgjegjësisë dhe ka fshehje. Ushtria po del atje që s'ka ushqim. Dalin deputetët thonë, si rasti i një deputeti të caktuar, që ka edhe konflikt interesi të flasë për ushtri, i mazhorancës, thotë: "Nuk janë të vërteta, se është furnizim i mjaftueshëm".

Andaj, unë po e shoh që nuk ka efekt diskutimi ynë, por do të ketë, sepse s'po kemi vota ta kalojmë atë rezolutën të cilën ia kemi rekomanduar Qeverisë që t'i kryejë detyrat e veta. Jam shumë optimist që do të kenë efekt te qytetarët e Kosovës që do ta bëjnë veprimin e vet dhe njerëzit e papërgjegjshëm njëherë e përgjithmonë duhet larguar nga përfaqësimi që ia bëjnë institucionet. Në vend se ta rrisin nivelin e shtetit, ne secilën fushë po e degradojmë. I kemi degraduar me siguri, me Prokurori, me Gjykata, me Polici, me mësimdhënës. Nuk e di kujt po i shkon kjo për shtat, por veç një mund ta them, që neve si Kosovë nuk po na shkon për shtat. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Bekë Berisha!

BEKË BERISHA: Nuk është fjala e fundit, se ka edhe deputetë të tjerë.

Faleminderit, kryesues!

U provokova prej deputetëve, se po më duket ne e zhveshëm këtë Qeveri prej të gjitha këtyre rrenave, po tash çka më bëri përshtypje, që unë kur i shoh këto turma të ekzaltuara, kështu për inat, qysh e pashë një tubim, ndërsa vendi është në krizë e ushtria pa bukë. Ky Hajdari e përmendi Presidenten, s'di as çka duhet thënë Presidentes. Çfarë roli, as që më ka rënë në mend.

Tjetra, ai mban tubime atje, turma të ekzaltuara të njerëzve e duke i thënë: Albin baba. Këtu dënohet zyrtari i ministrisë, rrogën shtatëqind euro, rrogën e vogël e fitimi i madh që thoshte ky.

E ky i kishte blerë katër banesa edhe 150 mijë euro në bankë. Këtë po e njihnin njerëzit. D.m.th. këto i ka bërë që katër-pesë muaj. Është i arrestuar, ky Hafizi.

Tashti, këto tubimet, këto turmat që mblidhen, dhjetë metra prej Kuvendit këtu, është sheshi Bashkim-Vëllazërim. Shoku Tito aty i ka mbledhur 75 mijë shqiptarë, kanë dalë e kanë pritur, kanë piskatur, edhe atij i kanë thënë: babë.

Unë si një djalë i ri, si një patriot e shqiptar në takat timin, veç në një organizim edhe në një tubim kam marrë pjesë, kurrë në jetë timen nuk i kam çuar duart të hallakatem ashtu për askënd në këtë botë, veç në UÇK aty me do djem e çika të reja, deri në ditën e fundit për ta fituar lirinë. E mjaftueshëm kam qenë.

Kur u bë manifestimi i UÇK-së në Prishtinë, kam qenë si spektator, këqyrsha e u kënaqsha, se m'u duk se e fituam lirinë edhe u krye. Po si çohet burri me mustaqe e piskat: baba-baba. Nuk e ka babë atë, e sheh baba i vet biologjik duke i thënë baba dikujt, e ai duke e dështuar shtetin, edhe "baba-baba".

Sa duhet të ketë njeriu urrejtje për vendin e vet, hidhërim, t'i thuhet baba Albin Kurtit, në sy të babait të vet? Veç thonë nga inati që i është mbledhur, njëfarë mllani që e ka ai kundër Kosovës. Edhe i rrente, thoshte: "Shteti u pasurua, individi është varfëruar". Çka është shteti? Çka është nocioni shtet për këtë njeri? Unë mendoj që shteti është polici, ushtari me ushqim e veshmbathje, me dinjitet e me integritet, e punëtori i administratës, e punëtori i AKI-së. Ky është shteti. Shteti nuk është bust. Shteti janë njerëzit, punëtorët, administrata, ata që e zhvillojnë shtetin, që e forcojnë shtetin, politika, e besa edhe vetëdija kombëtare. Ky u thoshte njerëzve: unë e kam pasuruar shtetin, e kam varfëruar individin, se shteti është bust, e ata thoshin: baba. Ai duke vjedhur sa mundet, hajni që s'mbahet mend.

Cila ishte edhe një rrenë tjetër? Po thoshte: "Nuk ka të punësohen njerëzit me lista të partive, as me mbiemra familjarë". Ne e dimë të gjithë këtu që të gjithë i kanë vëllezërit të punësuar, gratë e krejt nepotizëm. Edhe hajni më e madhe nuk mbahet mend ndonjëherë që është bërë në këtë vend.

Është një këngë në Shqipëri, thonë: "Rruga e kuqe, rruga e nderit". Këta janë të kuq, nuk ka nder në rrugë të kuqe. Ky popull duhet të vetëdijësohet. Në rrugë të kuqe, nuk ka nder. Ka kështu buste, ka njerëz pa integritet që i thonë baba këtij, edhe ky baba i tyre e çon poshtë shtetin e Kosovës.

Unë e di që janë edhe disa deputetë, e pastaj po e përmbyll me rezolutë. Faleminderit!

KRYESUESI: Ganimete Musliu!

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, z. Hoxhaj!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës,

Ushtarë e oficerë të Kosovës,

Ju që ishit, jeni krenaria e vendit tonë e që sot po përballeni e po sfidoheni me sfida të rënda deri në poshtërim. Ju djem e vajza të kombit që keni respektin e mirënjohjen e secilit qytetar, por jo të Qeverisë Kurti, e cila çdo minutë po e teston durimin tuaj dhe të qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Edhe këtë seancë, që është shumë e rëndësishme, veçanërisht për momentin që po kalojnë Forcat tona të Armatosura, Qeveria e vendit dhe Lëvizja Vetëvendosje ka vendosur që ta injorojë këtë seancë. Kjo Qeveri në krye me Albin Kurtin, jorastësisht ia ka mësyre degradimit të ushtrisë, duke i thyer moralisht ushtarët dhe duke i demotivuar çdo ditë, duke shkatërruar njërin nga institucionet më të vlerësuara dhe më të respektuara në vend.

Situata e krijuar sa i përket gjendjes së furnizimit me ushqim të ushtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës ka alarmuar çdo qytetar dhe na ka shtyrë edhe neve që të mblidhemi dhe të ngremë shqetësimet tona për këtë çështje dhe të kërkojmë llogari.

Situata e përgjithshme e sigurisë gjatë dhjetëvjeçarit të fundit ka ndryshuar në mënyrë dramatike. Andaj, në vend që sot ne bashkë me Qeverinë të mblidhemi, të flasim për mundësitë e zhvillimit dhe të modernizimit të ushtrisë, ne duhet të flasim për çështje bazike a elementare, që asnjëherë nuk do të duhej të ndodhte.

Para se të flas, për çështjen që është thirrur kjo seancë, unë dua t'i bëj thirrje ministrit Maqedonci që të vijë në Kuvend dhe ta mbajë anën e ushtarëve, sepse ardhja e tij në pozitën e ministrit i ka gëzuar ushtarët dhe u ka dhënë shpresë se një ministër i dalë nga ata, do të dijë më së miri ta mbrojë dinjitetin dhe integritetin e tyre.

Qeveritë shkojnë e vijnë, por ushtria bashkë me krenarinë dhe lavdinë e saj mbetet. Prandaj, mos lejo që të biesh prej e lakmisë së pushtetit. Eja në Kuvend dhe trego të vërtetën mbi gjendjen e rëndë që ti e di më mirë se çdokush në këtë sallë e në këtë vend. Ti e di se gjendja me ushqimin është vetëm maja e ajsbergut e dështimeve të Qeverisë dhe të problemeve që ka FSK-ja. Heshtja dhe indiferenca nuk janë rruga e drejtë, as për Qeverinë, as për opozitën, as për qytetarët dhe as për ty, ministër.

FSK-ja fatkeqësisht nuk përballlet vetëm me problemin e ushqimit. Prandaj, ministër, duhet të vishë e të raportosh për shumë çështje e probleme me të cilat po përballlet FSK-ja. Duhet të raportojë ministri për ushtarët e FSK-së janë të rrezikuar çdo ditë nga automjetet e paservisuar.

Mbi pesëdhjetë nga to i ke çdo ditë në trafik. Të raportojë për demobilizimin masiv të ushtarëve e oficerëve deri në gradën kolonel.

Ministri duhet të vijë të raportojë për kombibusët që kanë qëndruar me javë në parkingun e FSK-së dhe i janë kthyer operatorit ekonomik. Me këtë do të duhej të merrej edhe Prokuroria. Ministri duhet të vijë të raportojë edhe për uniformat jashtë çdo standardi që kanë marrë ushtarët para disa javësh. Ministri duhet të vijë të raportojë edhe për mungesën e letrës së bardhë, me çka ballafaqohen çdo ditë punëtorët e këtij institucioni.

Ministri duhet të vijë të raportojë edhe për keqpërdorimin me 3 500 drurë dekorativë që janë mbjellë në kazermën “Adem Jashari” në tetor të vitit 2022 e që sot nuk i ke as dhjetëra nga ta.

Ministri duhet të vijë të raportojë edhe për automjetin transportues Prishtinë-Ferizaj, për të cilën u desh ushtarët të paguajnë tetë mijë euro nga xhepi i tyre për ta riparuar. Ministri do të duhej të vijë të raportojë edhe për të famshmin e ashtuquajtur Fondin e Sigurisë. Kanë kaluar më shumë se dy vjet që nga themelimi i këtij fondi dubioz, dhe askush nuk e di se cilat janë rezultatet e këtij fondi. Jo që nuk u blenë armë siç propagandohej nga disa individë qeveritarë, që as idenë s’e kanë se sa kushton armatimi. Po kjo Qeveri nuk po ia del të kujdeset as për pagat e dinjitetshme, as për veshmbathjen e ushtarëve të këtij vendi. Në fund, nuk po ia del as t’i ushqejë si duhet ushtarët e Kosovës.

Gjendja në të cilën e kanë katandisur Ministrinë e Mbrojtjes udhëheqësit e saj është e patolerueshme. Asnjë propagandë e asnjë postim patetik i Albin Kurtit nuk ia del që ta mbulojë realitetin. Albin Kurti çdo ditë i frikëson qytetarët me luftë, e po harron se në luftë nuk mjafton vetëm guximi kundër breshërive të plumbave të armikut, gjë që nuk u mungon ushtarëve tanë, po nuk është e mjaftueshme, pasi duhet të ketë një avantazh të mirë të armëve sulmuese dhe mbrojtëse, teknikë dhe aftësi teknologjik dhe njohje në zbatimin e suksesshëm të strategjisë së artit ushtarak të luftës. Në luftë nuk shkohet për të mësuar, por shkohet i mësuar, i stërvitur, i pajisur dhe i ushqyer.

Ministri Maqedonci dhe i gjithë stafi menaxhues i FSK-së, duhet ose të reflektojnë me politikat e tyre, ose ta dorëzojnë postin që mbajnë, sepse performansa e tyre është zero dhe me tendencë shkatërrimi për FSK-në.

Ne si opozitë kemi treguar durim dhe konstruktivitet përballë një Qeverie shkatërruese, por sot nuk duhet të tregojmë as durim, as konstruktivitet. Sot duhet të bëjmë çmos që ta ndalim shkatërrimin e ushtrisë së Kosovës, asaj ushtrie që ka dalë nga gjiri i popullit dhe është ndërtuar mbi gjakun e dëshmorëve dhe të fëmijëve të Kosovës.

Nëse nuk tregojmë këmbëngulësi në opozitarizmin tonë përballë këtij shkatërimi, nesër nuk do t'ia dalim të shfajësohemi. Të mos harrojmë se pas uniformës së çdo ushtaraku jeton një civil në betim. Ushtarakët janë njerëzit më guximtarë dhe më të mirë që i ka shteti në shërbimin e tij, prandaj, e kemi obligim që t'u përgjigjemi pa dallim kërkesave të tyre.

KRYESUESI: Zoti Xhavit Haliti e ka fjalën.

XHAVIT HALILIT: Faleminderit, kryetar i seancës!

Nuk e kisha ndërmend të flisja, sepse mendoj që të gjithë kemi folur dhe kemi shtruar një çështje, pastaj të shumëzuar në shumë çështje të tjera, të cilat dhe për të cilat dikush duhet të japë llogari. Ata që duhet të japin llogari para këtij Kuvendi është Qeveria. Fatkeqësisht, kjo Qeveri është e papërgjegjshme, sepse po i ikën debatit dhe po ikën nga Parlamenti i Kosovës, që mendoj se është jo vetëm akt politik i papranueshëm, por është shkelje e Kushtetutës së Kosovës, sepse ata me ligj janë zgjedhur dhe me ligj e kanë për obligim edhe me Kushtetutë të japin llogari.

Nuk jam shumë i informuar, por po i shoh në media këto kompanitë që po shtyhen mes vete dhe individë që janë përplasur brenda për brenda institucionit të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së. Nuk jam i sigurt dhe s'di kush është fajtori dhe pse nuk ka kaluar tenderi, i cili dikush po thotë është ilegal, dikush ndryshe, dikush ashtu. Por, po besoj që domosdoshmërisht jam me kërkesën që Prokuroria e vendit të ndërmarrë masa dhe të ndërmarrë hapa që çështjet të shqyrtohen dhe çështja, ata që janë fajtorë të përballen me ligjin, në qoftë se ka korrupsion gjithsesi.

Ata që marrin vesh nga politika dhe nga mënyra se si funksionojnë institucionet e Kosovës, e dinë që tenderët historikisht kanë qenë fenomene të përplasjeve edhe brenda këtij Parlamenti, por në këtë rast, unë po besoj që ka ndoshta edhe një veprim shumë të rëndësishëm të FSK-së dhe të Qeverisë, sepse nga teoria dhe mënyrat e funksionimit të ushtrive, të forcave speciale të ushtrive, ndodh nganjëherë që i nxjerrin ushtarët nga një muaj ditë i lënë vetëm nëpër mal pa pasur mundësi që të hanë asgjë, pa ju dhënë as ushqim, sepse ai është një ushtrim që e bëjnë ushtarët dhe forcat speciale që të jenë të përgatitur dhe t'i rezistojnë çdo situatë edhe kur s'ka bukë.

Po shpresoj që ky është një rast ushtrimi i ushtrisë së Kosovës që të përgatite për situata të jashtëzakonshme që të mos ketë ushqim.

Megjithatë, këta para mediave dolën edhe thanë krejt është në rregull ushqimi. Komandanti tha s'ka ushqim, s'ka bukë. S'ka ushqime tradicionale që hahen aty. Prandaj, unë mendoj që ne mund të flasim edhe një javë këtu edhe mund të vazhdojmë debatet edhe ditëve të tjera, por këtë çështje duhet ta marrë në duar Prokuroria e Shtetit dhe duhet ta mbyllë me një deklarament ose me një veprim publik, i cili duhet të jetë i qartë për secilin në Kosovë, cili është faji dhe kush është fajtori. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Haliti! Fjalën e ka Eliza Hoxha. Le të përgatitet Mërgim Lushtaku.

ELIZA HOXHA: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Qytetarë të dashur,

Media,

Nëse ka një epitret që mund t'i atribuohet Qeverisë Kurti, është qeveri e klasifikuar, tinëzare, e fshehtë, sekrete.

Qeveri jotransparente, e mbyllur, pa llogaridhënie, thjesht Qeveri jodemokratike dhe e papërgjegjshme. Situata rëndohet edhe më shumë kur shoh që kolegët tanë nga mazhoranca në Kuvend nuk vijnë këtu dhe nuk e ushtrojnë mandatin e tyre kushtetues për të diskutuar e dialoguar së bashku mbi fenomenet dhe problemet që shoqëria kosovare, e në këtë rast edhe Forca e Sigurisë së Kosovës po kalon.

Ata e kanë parë më të arsyeshme të dalin në media përmes një konference për shtyp, e që unë ju them që mediat janë këtu në sallë zakonisht, por edhe korridoret e Kuvendit kudo, dhe të gjitha që mund t'i thonë duhet t'i shoshitim këtu së bashku.

Nuk marrim pjesë në seancë, sepse po na e imponojnë agjendën, tha kolegu yni i dashur i mazhorancës. Imagjinojeni! Për këtë koleq imponim i duket seanca e jashtëzakonshme, e cila është instrument ligjor, kushtetues i këtij Kuvendi.

Krejt këto lëvizje e kriza të shkaktuara me tendencë e me koordinim janë platforma të zotit Kurti për të zbehur, shkundur e lëkundur secilin institucion e person me integritet e kredibilitet në këtë vend. A ju kujtohet kur fliste për republikën e tretë? Siç duket, ai kështu e sheh republikën e tretë. Të nënshtruar, të varfëruar në çdo aspekt. Të çmontuar e demoluat, sepse sa më shumë e dobëson, më lehtë e kontrollon.

A ju kujtohet Fondi Sovran? Edhe ai ishte i klasifikuar. Edhe veshjet, edhe kamionët. A ju kujtohen edhe rezervat shtetërore të klasifikuara ishin. Dhe, krejt këto i bëjnë për të krijuar gjendje emergjente të paqena vetëm për të mundësuar kontrata të negociuara e sekrete për ta diktuar edhe tregun e lirë e për ta ngufatur atë.

Abuzimet kanë nisur t'u dalin me të madhe nga krimet ekonomike që janë procese hetimi në shumë nga dikasteret e edhe kjo për çfarë po flasim sot është një nga to. Kjo është një pasqyrë e njerëzve të cilët nuk e duan vendin e tyre, por e duan më shumë idenë për veten dhe për vendin që u nënshtrohet atyre.

E kur e mendoj anën tjetër se akti më i lartë i dashurisë për vendin është atëherë kur njeriu vë veten dhe jetën e tij përpara për sigurinë, jetën dhe lirinë e tjetrit, e këta janë ushtarët. Pishtarët tanë të përherëshëm për paqen dhe për të ardhmen. Kosova e ka njohur këtë ndjesi në luftën për liri përmes Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, por edhe në liri për siguri e stabilitet e paqe përmes TMK-së dhe FSK-së.

E sot, në vend se të flasim për vlerësimin mbi aktin më të lartë të dashurisë për vendin, për përkatësinë e integritetin, për idealin, për transformimin e zhvillimin për të ardhmen e sigurt, për mirëmbajtjen e paqes, ne sot flasim për një situatë të jashtëzakonshme, e duhet të kthehemi te nevojat bazike në piramidën e nevojave njerëzore, që janë nevojat fiziologjike siç është ushqimi, e nevoja për siguri, kur flasim për mungesën e ushqimit si siguri. Imagjinojeni!

Nga njerëzit kërkohet të punojnë për sigurinë, e kjo Qeveri nuk është në gjendje këtë nevojë bazike të sigurisë, pra për ushqimin, ta bëjë realitet. Domethënë, këta lëre që nuk kanë investuar a punuar për të ardhmen, për sigurinë fizike, gjeografike, e kibernetike, do të thosha, këta vjedhin në bukë e në fasule.

Domethënë, FSK është pa ushqim, sepse këta s'po mund të merren vesh për ushqimin e tyre korruptiv, se cila kompani u konvenon atyre. Për besë, pak është si e turpshme kjo situatë që flasim për gjëra kaq ekzistenciale, qoftë në institucione, qoftë për neve komplet si shoqëri. Por, këta siç duket më nuk turpërohen për asgjë. Dhe, kjo siç duket ka të bëjë me arrogancën e numrave që ua ka errësuar pamjen. Ua ka errësuar mendjen. Besoj që është detyrë jona jetike si pozitë që të mos i lejojmë ta errësojnë të ardhmen e Kosovës. Sigurinë e saj. Lirinë e saj. Krenarinë e saj dhe pavarësinë e saj.

E kur jemi këtu, si mund të flasim për paqen dhe sigurinë, për transformimin e FSK-së, për shumë gra që janë të nevojshme të jenë pjesë e këtyre formacioneve, e që sot i kemi vetëm 10%. Për mungesa të tjera në pajisje e shërbime, kur vetëm 8 muajt e fundit mijëra ushtarë e kanë lënë FSK-në, e plot të tjerë punojnë punë dytësore për ta mirëmbajtur veten, familjen dhe jetën.

E kur jemi këtu, i kujtoj platformat tona ndërkombëtare për paqe dhe siguri të organizuara nga presidentja jonë e vendit, ndërsa asgjë konkrete për forcën dhe sigurinë e Kosovës. Ndoshta edhe kjo është një mënyrë e nënshtrimit ndaj krejt asaj se çfarë bën zoti Kurti. Ndoshta edhe ky është qëllimi.

Në kohën kur bota e regjioni flet për siguri dhe nevojën për paqe e stabilitet, ne të vijmë këtu e të flasim për ushqim. Kjo jo vetëm që flet për mungesë vizioni, por thjesht është pazotësi qeverisëse. Është një pasqyre e një Qeverie të zhveshur nga çdo përgjegjësi. Qeveri pa rezultate pune. Qeveri e krizave dhe përçarjes. Qeveri e mashtrimit, fjalëve, propagandës. Qeveri e klasifikuar. Tinëzare e dinake.

Qeveri që vjedh edhe të tashme, por edhe të ardhmen. Qeveri që e vjedh sigurinë, duke vënë në luhatje lirinë dhe pavarësinë e shtetit të Kosovës.

KRYESUESI: Zoti Lushtaku e keni fjalën.

MËRGIM LUSHTAKU: Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Të nderuar ushtarë të ushtrisë së Kosovës,

Sot po diskutojmë një çështje tejet shqetësuese dhe jashtëzakonisht të rëndësishme. Vet fakti që duhet të flasim për ushqimin e ushtrisë sonë. Për nevojat më bazike të atyre që e mbrojnë vendin tonë, tregon qartë se në çfarë gjendje të mjerueshme është katandisur shteti ynë.

Sa për partinë në pushtet po shihet qartë edhe në Kuvend të Kosovës edhe prapa nesh se si përfaqësuesit e Qeverisë ikin nga debati. Pse? Sepse nuk kanë zgjidhje, nuk kanë alternativë, nuk kanë ekip profesional, dhe mbi të gjitha, nuk kanë vullnet për t'u përballur me faktet kokëforta që çdo ditë e më shumë po ia kujtojnë edhe vetë qytetarët.

Nga dita e parë që kjo Qeveri e mori pushtetin, ushtria e Kosovës është përballë me sfida të panumërta. E të mos flasim për mungesën e sigurimit shëndetësor dhe mospagesën e shtesave të rrezikshmërisë, të cilat kjo Qeveri e kishte për detyrë t'i siguronte. Por, jo vetëm që nuk kanë marrë masa për këto probleme ekzistuese, ata me vetëdije të plotë i kanë shtuar vështirësitë për ushtarët tanë.

Rreth një viti më parë, Qeveria vendosi që si mjet transporti për ushtarët të caktojë një autobus me kapacitet të vogël që nuk mjaftonte as për ushtarë. Transporti i kaluar nuk i kishte zgjidhur problemet e transportit, e ai edhe më tutje vazhdonte t'i vështirësonte edhe më tej problemet e tyre.

Më e rëndësishmja, sa për informimin edhe të kolegëve deputetë edhe të gjithë qytetarëve edhe të mediave, ku mbi 500 ushtarë, duke përfshirë edhe oficerë të lartë janë larguar nga Forca e Sigurisë së Kosovës për shkak të ambientit toksik që Vetëvendosja e ka sjellë në ushtrinë e Kosovës. Këta burra e këto gra që kishin për detyrë mbrojtjen e atdheut nuk u larguan për pagën, por për shkak të përcmimit dhe nëpërkëmbjes që përjetuan.

Skandali i fundit me ushqimin e ushtrisë është kulmi i papërgjegjësisë. Mungesa e ushqimit për ushtarët tanë është një problem alarmant për Kosovën, që Qeveria po e injoron me një ashpërsi të frikshme. Megjithëse ka kohë që u paralajmërua se nga 30 shtatori ushtria do të përballet me një mungesë të ushqimit, Qeveria as që ka lëvizur për t'i zgjidhur këto probleme.

Dhe, çfarë bën Qeveria? Bën hajgare me ushqimin e ushtarëve tanë. Vonojnë furnizimin dhe caktojnë kuzhinierë të përkohshëm të cilët as nuk paraqiten në punë.

Ndërsa, në anën tjetër, gjenerali Bashkim Jashari është detyruar të reagojë dhe ta paralajmërojë ndërprerjen e të gjitha aktiviteteve të ushtrisë nëse kjo situatë nuk zgjidhet menjëherë. Në raportimin e tij, Jashari ka përmendur qartë problemet me ushqimin, personelin e kuzhinës, furnizimin me artikujt ushqimorë dhe rrezikun e përhapjes së infeksioneve për shkak të kushteve sanitare të mjerueshme.

E gjithë kjo është një pasqyrë e një qartë e korrupsionit të kësaj Qeverie. Një tender që ishte rreth 2 milionë euro, e ai tjetri që ishte rreth 8 milionë euro për furnizimin me ushqim, është dhënë pa konkurrencë dhe me favorizim për kompanitë që ata duan.

Çështja nuk është vetëm cila kompani e fiton tenderin, por që ushtarët tanë të marrin ushqimin e duhur dhe cilësor. Ata janë bijtë më të mirë të këtij vendi dhe meritojnë trajtim të mirë dhe me ndershmëri. Mirëpo, kjo Qeveri e Vetëvendosjes që e ka pasur kohën e duhur për të ndjekur procedurat ligjore dhe për të ofruar një zgjidhje të qëndrueshme, e ka zgjedhur rrugën e mashtrimit dhe të korrupsionit.

Kjo Qeveri e skandaleve dhe e korrupsionit masiv ka arritur deri aty sa të dëmtojë sektorët më të ndjeshëm të shtetit siç është ushtria jonë. Për të gjitha këto arsye kërkoj masa të menjëhershme dhe zgjidhje të shpejta. Çdo ditë që kalon nën pushtetin e Qeverisë Kurti është një ditë e humbur për Kosovën dhe për të ardhmen tonë. Koha është që ta ndryshojmë tani.

KRYESUESI: Fjalën e ka deputeti Agim Veliu dhe le të përgatitet Isak Shabani.

AGIM VELIU: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Të dashur ushtarë,

Problemi i furnizimit me ushqim i Forcës nuk është problem as shkencor, as teknik, as taktik, as kalorik e proteinik, as problem i natyrave të tjera të ngjashme me këto.

Problemi është fund e krye manipulativ, abuziv e korrupsion i Ministrisë së Mbrojtjes, e cila po funksionon në dy binarë partiakë e mbi baza nepotizmi. Në këto rrethana nuk është e habitshme që Forca e Sigurisë ka mbetur pa ushqim.

E habitshme është si dhe pse edhe kaq ditë pas skandalit më të madh nuk merret askush me gjetjen e zgjidhjes së shpejtë, me përjashtim të përpjekjeve kush kujt t'ia lë fajin.

Janë të neveritshme e sjelljet e presidentes si komandante supreme e Forcës së Sigurisë së Kosovës, e Qeverisë, e ministrit dhe e kryeministrit. Nuk e di si arsyetohen këto veprime të Qeverisë, kryeministrit dhe mungesa e deputetëve të shumicës në këtë seancë kur po diskutojmë për këtë çështje kaq të rëndësishme.

Kryeministri po të ishte këtu ndoshta do ta arsyetonte me atë lojën e fjalëve, po ai, për besë, siç e ka ai zakon ta përdorë kur gënjen, ndoshta e ka gjetur formulën; ushtria e Kosovës nuk ka nevojë, ndoshta, sipas tij, të hajë, qysh bën ai lojë fjalësh, tri-katër herë në ditë, po i mjafton të hajë një herë në tri-katër ditë. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Shabani, e keni fjalën. E lus propozuesin e kësaj seance të jashtëzakonshme meqë e kam edhe një deputete të fundit që do ta marrë fjalën, që të jenë të pranishëm në sallë kur duhet ta propozojmë projekt-rezolutën. Zoti Shabani, e keni fjalën.

ISAK SHABANI: I nderuari kryesues i Kuvendit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë,

Një parafolës më herët theksoi se edhe në kohë lufte Ushtria Çlirimtare e Kosovës është furnizuar me ushqim të mjaftueshëm në rrethana dhe në kushte të luftës. Kurse sot është një shqetësim që kemi ardhur deri në këtë gjendje që të bisedohet për bukën e ushtrisë së Kosovës.

Unë nuk dua ta zgjas shumë për shkak se parafolësit folën gjerë e gjatë. Unë dua ta them vetëm një shqetësim dhe një këshillë. Një shqetësim e kam se ministrja e Drejtësisë ka lejuar që kuzhinierët e qendrave korrektuese të burgjeve që përgatisin ushqimin për të burgosur të shkojnë në kazemat e ushtrisë që të përgatisin ushqim.

Kurse ministrja e Arsimit ka lejuar që kuzhinierët e Qendrës së Studentëve të shkojnë në kuzhinën e ushtrisë për të përgatitur ushqim. Shqetësimi im është i vetëm, se kur po e shoh mungesën e këtyre dy ministrave, të ministrave dhe të deputetëve të VV-së, është shqetësim se mos kanë shkuar edhe këta në kazerma të ushtrisë për t'ua përgatitur ushqimin. Domethënë, t'i futin duart në kazanët e ushtrisë.

Po shpresoj që aty ka ndonjë mbikëqyrës e nuk i ka lejuar asgjë tjetër përveç nëse kanë shprehur gatishmëri t'i ndihmojnë ushtrisë në përgatitjen e ushqimit, të kenë mundësi vetëm t'i lajnë enët pas ngrënies së ushqimit.

Një shqetësim tjetër është, kryekuzhinieri i Kosovës këto ditë është nëpër Evropë edhe ai është duke u servuar racione mërgimtarëve, dhe në ato racione, ne po e dimë të gjithë, është duke shtuar shumë kripë.

Prandaj, për ata që e kanë kërkuar nuk mund të them asgjë. Për ata që në të ardhmen do të shijojnë racione të cilat kryeministri është duke ia servuar Diasporës, të kenë kujdes se kripa e tepruar ua dëmton shëndetin. Faleminderit!

KRYESUESI: E fundit për këtë seancë, jo për nga rëndësia, zonja Floretë Zejnullahu.

FLORETË ZEJNULLAHU: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë,

Sot jemi mbledhur për të diskutuar një çështje për të cilën askush nga ne nuk do të dëshironte që të fliste kaq vite pas luftës.

Kosova, vendi ynë është ndërtuar me gjak, me mund, me sakrificë e me përpjekje të shumë brezave ndër shekuj. Sot, fatkeqësisht shteti ynë po përballet me një krizë të thellë që po godet mu në zemrën e sigurisë sonë kombëtare, në ushtrinë e Kosovës. Ky nuk është një dështim i zakonshëm, është një skandal që sfidon vet themelet e shtetit tonë.

Ne që veç para 25 viteve luftonim për ta mbrojtur këtë vend, nuk mund ta imagjinojmë kurrë se në vitin 2024 ushtria jonë do të mbetet pa ushqim. Megjithatë, ky është realiteti me të cilin po ballafaqohemi sot.

Ushtria jonë është institucioni më i besueshëm për të gjithë qytetarët e Kosovës. Ajo është krenaria më e madhe. Në FSK shërbejnë djemtë dhe vajzat më të mira të këtij vendit, të cilët kujdesën për sigurinë 24 orë. Sot, situata në Forcën e Sigurisë është shqetësuese. Është alarmante mënyra se si Qeveria po e trajton Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Partia në pushtet, Vetëvendosja përmes personave të caktuar me qëllim të përfitimeve personale ka tentuar të vjedh 10 milionë euro përmes një tenderi të turpshëm për ushqimin e ushtarëve. Për këtë arsye, sot ushtria jonë është pa ushqim, pa veshmbathje të duhur, edhe pa dinjitetin që e meriton ushtari.

Si mund ta krahasojmë këtë situatë me kohën e luftës. Atëherë e kishim një ushtri guerile e cila asnjëherë nuk mbeti pa bukë.

Sot, një ushtri e një shteti të pavarur po trajtohet me përçmim. Jo për një arsye të natyrshme, por për shkak të një Qeveri që kërkon të përfitojë nga pasuria e vendit, duke e shitur edhe nderin e ushtarit.

Kjo Qeveri e paaftë dhe me mision të dyshimtë po përpiqet të shkatërrojë çdo gjë që është ndërtuar deri më sot.

Të dashur qytetarë,

Qeveria po luan me themelet e sigurisë dhe po e lë pa furnizim të qëndrueshëm ushtrinë. Kjo është tradhti ndaj çdo qytetari të këtij vendi, ndaj çdo ushtari që mban armën në dorë për ta mbrojtur lirinë dhe sigurinë e Kosovës.

Ministria e Mbrojtjes sot udhëhiqet nga një ministër kukull, i cili nuk është i lirë ta kryejë punën e vetë, por dirigjohet tërësisht nga udhëheqja e komiteteve të Vetëvendosjes, e po ashtu edhe nga kryeministri.

Kanë kaluar tashmë dy javë që ushtria e Kosovës ballafaqohet me probleme në furnizim me ushqim. Ky skandal nuk ka ndodhur asnjëherë që formimi i institucioneve tona. Pse Qeveria nuk e largoi operatorin e deritanishëm që në fillim të mandati? Si u bë që persona të caktuar në ministri të nënshkruajnë kontrata sekrete për ushqim? Çfarë sekreti shtetëror mund të ketë në këtë proces?

Sot, po mundohen të sigurojnë ushqim për ushtarët, duke thirrur kuzhinierë nga Mensa e Studentëve apo qendrat e korrektuese për të përgatitur vetë ushqimin. Pyetja ime për ministrin është: Në cilat ushtri të vendeve demokratike ndodh kjo? Përveç në vendet e Lindjes, apo në ato post-komuniste.

Ky nuk është veç një skandal i madh, ky është një dështim i qëllimshëm për të përfituar personalisht dhe për të dobësuar çdo institucion, duke ulur edhe moralin e ushtarëve tanë.

Përveç tenderit të ushqimit për ushtrinë e Kosovës, sot pyesim: çfarë po ndodh edhe me Fondin e Sigurisë? A është duke u vjedhur edhe në këtë fond? Si mund të kemi besim te një Qeveri që e lë ushtrinë pa bukë, sepse dëshiron të vjedhë në tenderët e saj? Si mund të besojmë te një Qeveri që ka bërë pazare miliona me kompaninë serbe GEN? Si mund të besojmë te një Qeveri që ka dhënë mbi 272 milionë euro tenderë njëburimorë? Si mund të besojmë te një Qeveri që ka vjedhur miliona euro nga rezervat shtetërore, duke i lënë qytetarët e Kosovës në pasiguri.

Të dashur kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë,

Si mund të lejojmë që një Qeveri e tillë të vazhdojë kështu? Pse ushtarët tanë duhet të jenë të shqetësuar se a kanë ushqim? Të jenë të shqetësuar për cilësinë e atij ushqimi, për veshmbathje dhe kushte bazike. Kujt i shkon në favor përçmimi, nënshtrimi dhe dobësimi i Forcës së Sigurisë? Kush qëndron prapa kësaj? E ftojme kryeministrin, ministrin e Mbrojtjes që të vijnë në seancë, të dalin para popullit dhe të tregojnë se çfarë po ndodh me Forcën e Sigurisë së Kosovës. Të mos mundohen që hajninë të na e shesin për patriotizëm.

KRYESUESI: Ju falënderoj, zonja deputete! Tash e ftoj Bekë Berishën në emër të deputetëve nënshkrues për këtë seancë të jashtëzakonshme që të prezantojë para jush propozim-rezolutën.

BEKË BERISHA: Faleminderit, kryesues!

Rezolutë

1. Kuvendi i Republikës së Kosovës kërkon nga Qeveria, Ministria e Mbrojtjes që me urgjencë ta zgjidhë çështjen e furnizimit me ushqim, si dhe me të gjitha pajisjet e tjera të nevojshme.
2. Zyrtarët përgjegjës në Ministrinë e Mbrojtjes duhet të japin dorëheqje, ministri i FSK-së, zëvendësministri, Sekretari i Përgjithshëm dhe e gjithë hierarkia përgjegjëse në Administratën e ministrisë.
3. Kërkohet nga Prokuroria e Shtetit që të hapet procedurë ligjore për të hetuar rastin, duke përfshirë edhe dyshimet për FSK-në për çështje të cilat kanë të bëjnë me interesa korruptive. Faleminderit!

KRYESUESI: Të falënderoj, zoti Berisha!

Meqë nuk ka kuorum dhe nuk ka të tjerë të paraqitur për fjalë, unë i ndërpres punimet e kësaj seance dhe për vazhdimin e saj ju informojmë si Kryesi e Kuvendit. Ju faleminderit!

* * *

E mërkurë, më 30 tetor 2024

Vazhdimi i mbledhjes së jashtëzakonshme, e filluar më 14 tetor 2024

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Glauk Konjufca.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Tani do ta trajtojmë një çështje që e patëm më 14 tetor, e që është:

1. Votimi i Projekt-Rezolutës nga debati parlamentar për mungesën e ushqimit në Ushtrinë e Republikës së Kosovës

Votojmë tash! Kjo është e 14 tetorit, domethënë. Mirë, e përsëritim. Votojmë tash!

61 vota. 61 vota kundër. Kështu që, konstatoj që nuk miratohet kjo rezolutë.

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*